

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 5987
E martë, 28 janar 2020
çmimi 0.40 €

Rrezikshmëri e ulët për coronavirusin në Kosovë

IFAQE 7



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", BEDRI ISLAMI I FAQE 4-5

PËRPLASJA HARADINAJ - RAMA NUK DO TË DUHEJ TË NDODHTE



Analisti politik Bedri Islami ka thënë se përplasia në mes të Ramush Haradinajt dhe Edi Ramës është e pakuptimtë, që ndodh mes dy shëfave të qeverive, të cilët i përkasin të njëjtit komb, të ndarë në shtete të ndryshme. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Islami ka theksuar se kjo përplasje mes tyre nuk do të duhej të ndodhte. "As Haradinaj dhe as Rama nuk janë tradhtarë, por as Rama dhe as

Haradinaj nuk e kanë në dorë të shesin pjesë të Kosovës, t'i ndryshojnë kufijtë apo ta përcaktojnë të ardhmen", ka thënë ai, duke shtuar se nëse kjo histori mes tyre do të vazhdojë, do të jenë që të dy të mundur, e faji do të jetë i përbashkët. Islami ka thënë se Kosova dhe Shqipëria duhet të kenë një platformë të përbashkët politike, ekonomike, zhvillimore, arsimore, të kulturës, energjisë, të financave dhe të tregtisë

LËVIZJA VETËVENDOSJE (LV) DHE LIDHJA DEMOKRATIKE E KOSOVËS (LDK) NUK LËVIZIN NGA POZICIONET

Posti i kryeparlamentarit, pengesë



Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti dhe ai i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, as të hënën nuk kanë arritur marrëveshje për bashkëqeverisje. Takimi që ishte paralajmëruar vendimtar nuk ka sjellë ndonjë rezultat, kurse zyrtarët e partive nuk janë deklaruar për media. Gjatë ditës së hënë zyrtarët e lartë të këtyre dy partive kanë treguar se pengesë është posti i kryeparlamentarit. Nënkrjetari i LDK-së, Agim Veliu, ka thënë se kjo parti nuk bën koalicion pa postin e kryetarit të Kuvendit. Ndërsa anëtari i Këshillit të Përgjithshëm të LV-së, Agim Bahtiri, ka thënë se kjo kërkesë e LDK-së është e paarsyeshme I FAQE 3

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

OPINION

'EPOKA E RE', LEGJENDË
ATDHETARE SHQIPTARE PËR
20 VJET F. 06

Nga: Ndue
DODAJ



LUFTA PËR GLAUKUN DHE
GRENELLI ANTE PORTAS! F. 10

Behxhet Sh. SHALA
- BAJGORA



MAGNETIZIMI I PLLAKAVE
FEROMAGNETIKE MBI POLET
E MAGNETIT (β) dhe (δ) F. 11

Shkruan: Naim
KRASNIQI, fizika



AKTUALE

MERKELI MBËSHTET HAPJEN E
NEGOCIATAVE PËR SHQIPËRINË F. 7

KOSOVA PËRKUJTON VIKTIMAT
E HOLOKAUSTIT F. 7

EKONOMI

KOSOVA DHE SERBIA DISKUTUAN
NË BERLIN PËR RIHAPJEN
E LINJËS HEKURUDHORE F. 9

VONESA PËR KRIJIMIN
E QEVERISË PO U SHKAKTON
DËME TË MËDHA BIZNESEVE F. 8

KULTURË

III. NDIHMESAT NË FUSHË TË
STUDIMEVE GJUHËSORE F. 14

Prof. asoc. dr. Myrvete Dreshaj-BALIU
Prof. dr. Begzad BALIU

WE E

Women in Energy

Gratë në Energji
Programi i Punës Praktike

Për të gjitha detajet:
[millenniumkosovo.org/
womeninenergy](http://millenniumkosovo.org/womeninenergy)

Thirrje për shprehje të interesit nga institucione dhe organizata të ndryshme në sektorin e energjisë në Kosovë, për angazhim të praktikanteve në punë, paguar nga MFK.

Në kuadër të projektit "Gratë në Energji - Women in Energy", të lansuar nga Fondacioni i Mijëvjeçarit i Kosovës (MFK), së shpejti do të fillojë zbatimi i programit "**Punë praktike për gra në sektorin e energjisë**" i cili ka për synim fuqizimin dhe përfshirjen e gruas në sektorin e energjisë në Kosovë.

Qëllimi i këtij programi është të mbështesë ngritjen e kapaciteteve të nevojshme profesionale të grave duke ju ofruar atyre përvojë përmes punës praktike me pagesë në institucionet publike dhe private të sektorit të energjisë në Kosovë. Paga bazike do të ofrohet nga MFK për kohë të caktuar deri në gjashtë muaj.

Përfituese të këtij programi do të jenë të gjitha gratë dhe vajzat që shprehin interesim për praktikë në punë në sektorin e energjisë e të cilat janë në vitin e fundit të studimeve Bachelor, studentet e nivelit Master, si dhe ato që kanë diplomuar në tri vitet e fundit por që nuk kanë pasur mundësi të punojnë në profesionet e tyre. Profili i vajzave aplikante do të përfshijë jo vetëm ato që i përkasin fushave STEM (Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë), por edhe disiplina të tjera të rëndësishme për sektorin e energjisë, të tilla si menaxhimi i projektit, marketingu dhe financat, ekonomia, legjislacioni, politikë-bërje, teknologjia e informacionit si dhe profile të tjera të nevojshme në këtë sektor.

Andaj, ju bëjmë thirrje të gjitha **institucioneve në sektorin publik dhe privat, organizatave joqeveritare si dhe organizatave ndërkombëtare** të angazhuara në sektorin e energjisë në Kosovë, që kanë nevojë për kontributin e profesionisteve të reja si dhe shprehin interesim për të bashkëpunuar në këtë program të aplikojnë në web faqen tonë:

millenniumkosovo.org/womeninenergy



**MILLENNIUM
FOUNDATION
KOSOVO**



MILLENNIUM
CHALLENGE CORPORATION
UNITED STATES OF AMERICA

Gratë në Energji / Programi i Punës Praktike

Yuri Kim: Pres të punoj me udhëheqësit e vendit tuaj

TIRANË, 27 JANAR - Ambasadorja e ShBA-së në Shqipëri, Yuri Kim mbajti fjalën e parë publike në marrjen e detyrës së saj. Pas dorëzimit të letrave kredenciale te presidenti i Republikës, Ilir Meta, Kim ka mbajtur një konferencë për mediet në zyrat e selisë diplomatike që do ta drejtojë në vitet në vijim. Yuri Kim u shpreh se po pret me kënaqësi që punojë me udhëheqësit politikë shqiptarë, të cilët po ndërmarrin hapa të vështirë, por të nevojshëm për reformën në drejtësi dhe për të larguar korrupsionin nga sistemi shqiptar.

"Jemi miq, jemi aleatë dhe jemi partnerë. Siç thashë gjatë seancës



time dëgjimore në Senat pak miq e kanë përqaftuar Amerikën. Jam nderuar të jem këtu para ndërtesës së Ambasadës së ShBA-së. Kjo ndërtesë e bukur qëndron si një testament për forcën e qëndrueshme të marrëdhënieve amerikano-shqiptare. Miqësia

jonë nuk u ndërtua në një ditë por rrënjët e saj janë të thella. 100 vjet më parë presidenti Eithdroë ngriti zërin për Shqipërinë kur askush nuk e bëri. Presidenti amerikan e përdori fuqinë e ShBA-së për të mbështetur një Shqipëri të pavarur. Kundër çdo gjase priti një

përfaqësues në ShBA dhe priti që pas Luftës së Dytë Botërore dy qeveritë tona morën rrugë të ndryshme", tha ajo.

Kim tha se edhe kur qeveritë nuk e njihnin njëra-tjetrën popujt tanë vazhduan ta mbështesin njëri-tjetrin.

"Kemi qëndruar krahë jush që atëherë dhe tani përpjekjet tuaja për t'u anëtarësuar në BE. Sot qëndrojmë pranë jush në mbështetje të ardhmes së Shqipërisë. E dimë se ka punë të vështirë përpara po dimë se puna e vështirë është më e lehtë kur ke miq dhe aleatë afër teje. ShBA-të janë të përkushtuara të ndihmojnë Shqipërinë të bëhet aleate më e fortë. ShBA-të janë të

përkushtuara të ndihmojnë Shqipërinë të përforcojë kandidaturën e saj për në BE", tha ambasadorja amerikane.

"Pres me kënaqësi të punoj me udhëheqësit e Shqipërisë. Jam besimplotë teksa drejtësia të hedhë rrënjë në Shqipëri më tepër investitorë do të vijnë në Shqipëri në mënyrë që të krijohen më tepër mundësi punësimi. Të mos ketë dyshime që ShBA-ja e vlerëson Shqipërinë si aleate dhe mike të vërtetë. Ashtu siç qëndruam më 1920, 1991, 1999, 2009, do e mbështesim vendin tuaj. Ju përsërisht dhe ju them "Ne jemi ende me ju krahë për krahë", tha ambasadorja Kim.

Merkeli mbështet hapjen e negociatave për Shqipërinë

Kancelarja gjermane Angela Merkel përsëriti të hënën se Gjermania mbështet hapjen së shpejti të negociatave të pranimit në Bashkimin Evropian për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut, duke kërkuar marrjen e vendimit për këtë çështje gjatë takimit të ardhshëm të BE-së në muajin mars



PRISHTINË, 27 JANAR - Kancelarja gjermane Angela Merkel priti të hënën në Berlin kryeministrin Edi Rama. Para nisjes së takimit, duke folur për gazetaret, Merkeli veçoi tri çështje për të cilat do të diskutonte me kryeministrin Edi Rama-përballimin e pasojave të tërmetit, marrëdhëniet Gjermani-Shqipëri dhe hapjen e negociatave.

Kancelarja vlerësoi rezultatet e reformës në drejtësi, por kërkoi që procesi të vazhdojë deri në përmblylljen e tij.

"Gëzohem që sot kemi mundësi të shkëmbejmë mendime me kryeministrin Edi Rama në këtë fillim viti, por dhe të zhvillojmë bisedime dypalëshe. Për mua është një nevojë e veçantë që përballë

tërmetit të 26 nëntorit në Shqipëri ku shumë njerëz humbën strehën dhe pati një numër të lartë viktimash të organizohet konferenca e donatorëve dhe Gjermania do të marrë pjesë aty. Bashkëpunimi dhe ndihma në rajon ishin impresionuese megjithatë tërmeti ishte goditje e rëndë për Shqipërinë. Ne do të flasim për disa çështje, marrëdhëniet dypalëshe, ato ekonomike, kursi i reformave. Më lejoni të them se janë arritur shumë gjëra në lidhje me reformën në drejtësi. Kjo duhet të vazhdojë që reforma në drejtësi të përmbillet, është e një rëndësie të veçantë për të ardhmen e Shqipërisë", tha Merkel.

Kancelarja Merkel gjithashtu vuri theksin edhe tek e ardhmja

evropiane e Shqipërisë.

"Në emër të Qeverisë gjermane dua të them se ne i përmbahemi perspektivës evropiane të Shqipërisë dhe për Ballkanin Perëndimor. Ne duam që këto shtete të përafrohohen me BE-në dhe që para së gjithash në Këshill në mars të nisim negociatat për anëtarësim me

Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Të dyja vendet kanë arritur të mëdha, edhe në Këshillin e fundit ne folëm për këtë dhe shpresojmë që në mars të marrim rezultatet që dëshirojmë. Nuk është në interes vetëm të vendeve të Ballkanit Perëndimor por dhe në interesin tonë dhe të

gjithëve që këto vende të bëjnë pjesë në BE. Ai që e njëjtin situatën e përgjithshme e di mirë që është mirë që një ditë këto shtete të bëhen anëtare të BE-së. Meqenëse Komisioni i ri Evropian thekson kriteret politike ka më shumë arsye për ta çuar përpara këtë proces", tha Angela Merkel.

Geoana: Intervenuam në Kosovë për të parandaluar një Aushvic të ri

BRUKSEL, 27 JANAR - Në Ditën Ndërkombëtare të Përkujtimit të Holokaustit, zëvendëssekretari i përgjithshëm i NATO-s, Mircea Geoana, deklaroi se 50 vjet pas Aushvicit, Aleanca e NATO-s ndërhyri në Kosovë për të parandaluar një gjenocid të ri.

Në fjalimin e tij para të pranishmëve, Geoana ka thënë se

Holokausti ishte një ofendim për të gjithë njerëzimin. "Kishte të bënte me shkatërrimin e atyre që janë ndryshe, por pikërisht e ndryshmjia është ajo që na bën neve unikë, na bën njerëzorë. Pas Luftës së Dytë Botërore, vendet e lira të botës kërkuar një shteg të ri, i cili u ndërtua duke ruajtur vlerat universale të përcaktuara në Kartën

e Kombeve të Bashkuara. NATO-ja u krijua për t'i mbrojtur këto vlera dhe për t'i mbrojtur njerëzit e Evropës dhe të Amerikës Veriore nga tirania që çoi drejt Holokaustit. 50 vjet pas Aushvicit, aleanca ndërhyri në Kosovë për të parandaluar një gjenocid të ri në tokën evropiane", tha Geoana, sipas faqes zyrtare të NATO-s në internet.



Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) nuk lëvizin nga pozicionet

Posti i kryeparlamentarit, pengesë



Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje (LV), Albin Kurti dhe ai i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, as të hënën nuk kanë arritur marrëveshje për bashkëqeverisje. Takimi që ishte paralajmëruar vendimtar nuk ka sjellë ndonjë rezultat, kurse zyrtarët e partive nuk janë deklaruar për media. Gjatë ditës së hënë zyrtarët e lartë të këtyre dy partive kanë treguar se pengesë është posti i kryeparlamentarit. Nënkryetari i LDK-së, Agim Veliu, ka thënë se kjo parti nuk bën koalicion pa postin e kryetarit të Kuvendit. Ndërsa anëtari i Këshillit të Përgjithshëm të LV-së, Agim Bahtiri, ka thënë se kjo kërkesë e LDK-së është e paarsyeshme

mes të Vetëvendosjes dhe LDK-së. "Ky proces duhet të mbyllet sepse çfarëdo epilogu që të ketë ky proces duhet të ketë një kohë që të kryhen disa punë dhe detyra që na presin, qoftë ai pozitiv apo epilogu tjetër. Edhe në rastin tjetër duhet të ketë kohë Vetëvendosja që t'i shqyrtojë pozicionet dhe të bëjë përpjekje të tjera. Sipas mendimit tim, sot duhet të ndodhë", ka thënë Veliu. Më pas ka reaguar edhe anëtari i Këshillit të Përgjithshëm i Lëvizjes Vetëvendosje, njëherësh kryetar i Mitrovicës, Agim Bahtiri, i cili ka thënë se kërkesa e LDK-së për dorëheqje të kryetarit të Kuvendit është e paarsyeshme. "Pas votimit nga 75 deputetë, LDK-ja duhet ta kuptojë se kryetari i Kuvendit të Kosovës, z. Glauk Konjufca, nuk është e arsyeshme të dorëhiqet dhe kjo nuk do të ndodhë. Pavarësisht prej refuzimeve të vazhdueshme të ofertave të Lëvizjes Vetëvendosje, LDK-ja për të mirën e vet dhe për hir të një qeverisje progresive dhe reformatore duhet ta pranojë ofertën e fundit të LV-së", ka shkruar Bahtiri në llogarinë e vet në "Facebook". LV-ja dhe LDK-ja për një kohë kishin ndërprerë takimet e drejtpërdrejta dhe komunikimi bëhej përmes letërkëmbimit. Të premtën e kaluar këto dy parti iu kishin kthyer takimeve, ku të dy liderët në ambientet e Universitetit Amerikan në Prishtinë kishin mbajtur një takim larg syrit të mediave.

Analistët: Dallimet në mes të LV-së dhe LDK-së janë të mëdha

Njohësit e rrethanave politike kanë shprehur skepticizëm se një koalicion LV - LDK do të jetë funksional edhe nëse ndodh. Analisti politik Faton Abdullahu ka thënë se këto subjekte politike kanë dallime të mëdha. "Apo, thënë ndryshe, dallimet dhe mospajtimet e tyre të mëdha dhe për kohë të gjatë deformuese do të jenë pjesë serioze e përçarjeve qeverisëse. Edhe nëse LV-ja dhe LDK-ja do të merren vesh ato nuk do t'i marrë vesh ShBA-ja. Mund të konstatohet kështu sepse ato jo vetëm se nuk janë pajtuar për shumë gjëra, por nuk janë pajtuar as për atë kryesoren: dialogun me Serbinë. Edhe nëse LV-ja dhe LDK-ja do të merren vesh për ta bërë qeverinë, qeverisjen e tyre nuk do ta marrë vesh në rend të parë qytetari i Kosovës. Që të dyja, LV-ja dhe LDK-ja, tash sa kohë nuk kanë qenë të sinqerta as me ata", ka thënë Abdullahu. Ai ka shtuar se edhe nëse LV-ja dhe LDK-ja pajtohen për ta bërë qeverinë, nuk kanë lënë të besohet se do të jenë unikë kundër Serbisë. "Si ka mundësi? Shumë e thjeshtë, LV-ja dhe LDK-ja nuk i besojnë njëra-tjetrës e pa besim nuk ka unitet. Edhe nëse LV-ja dhe LDK-ja merren vesh, do të jenë të pakuptueshme për shqiptarët jashtë Kosovës. LV-ja pranon të bashkëpunojë me

shqiptarët jashtë Kosovës vetëm nëse ata që më parë bëhen LV - marrëzi megalomane. Kurse LDK-ja me kosovacentrizmin e saj as që e merr mundin t'i kuptojë hallet e shqiptarëve të tjerë, as të jetë e kuptueshme për ata - marrëzi përjashtuese", ka shkruar Abdullahu. Sipas tij, LV-ja dhe LDK-ja do të jenë shumë dyshuese ndaj njëra-tjetrës edhe nëse e bëjnë qeverinë. "Edhe nëse LV-ja dhe LDK-ja pajtohen atyre jo që nuk do t'ju shkojë për dore që të bëjnë pajtim me përfaqësuesit e serbëve të Kosovës, por për shkak se, sidomos LV-ja, nuk ka bërë kurrë asgjë në këtë drejtim, ata do të jenë më dyshues e më kundërshtues ndaj LV-së e, për rrjedhojë, qeveria që do të udhëhiqej nga ajo. Edhe nëse LV-ja dhe LDK-ja pajtohen për të bërë qeveri, kjo do të dëshmojë se ata u pajtuan për ato që nuk janë pajtuar tash e gati katër muaj për më shumë pozita e pushtet. Pak moral në krejt këtë se do të qeverisin me parime", ka shkruar ai. Lideri i LV-së, Albin Kurti, të hënën e kaluar është mandatuar nga presidenti për kryeministër. Nga ajo ditë ka nisur rrjedhja e afatit të parë ligjor prej 15 ditësh për krijimin e qeverisë së re të vendit. Nëse lideri i LV-së brenda 15 ditësh nuk mund ta formojë qeverinë e re i mbetet në diskrecion presidentit të vendit, Hashim Thaçi, se kush do të jetë mandatar i dytë për formimin e qeverisë së re.

EPOKA
ERE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 27 JANAR - Lëvizja Vetëvendosje (LV) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) nuk kanë arritur marrëveshje për koalicion qeverisës as të hënën. Mbi dy orë bisedime në ambientet e Kuvendit nuk iu kanë mjaftuar liderëve, Albin Kurti dhe Isa Mustafa, që të gjejnë një zgjidhje për postin e kryetarit të Kuvendit të cilin e mban Glauk Konjufca. Pas takimit që ishte paralajmëruar vendimtar për arritjen e marrëveshjes nuk është deklaruar askush prej zyrtarëve të LV-së dhe LDK-së. Gjatë ditës së hënë Albin Kurti dhe Isa Mustafa kishin shprehur optimizëm se ky takim mund ta sillte marrëveshjen. Por, më pas, zyrtarët e këtyre

partive treguan se asnjëra palë nuk ka lëvizur nga pozicionet. Fillimisht, nënkryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Agim Veliu, ka thënë se janë duke pritur përgjigje nga Lëvizja Vetëvendosje në lidhje me ofertën e kësaj partie për bashkëqeverisje. Para mediave ai ka thënë se LDK-ja nuk ka hequr dorë nga pozita e kryeparlamentarit. "Ne jemi duke pritur nga Vetëvendosja që të deklarohet për ofertën tonë. Oferta jonë është me kryeparlamentarin, pesë ministri dhe zotimin për president", ka thënë Veliu. Sipas tij, oferta e LDK-së për bashkëqeverisje është e organeve drejtuese të saj dhe ajo duhet të respektohet nga LV-ja. Veliu ka thënë se duhet t'i jepet fund epilogut të negociatave në

Flet për "Epokën e re", Bedri Islami

Përplasja Haradinaj - Rama

Analisti politik Bedri Islami ka thënë se përplasja në mes të Ramush Haradinajt dhe Edi Ramës është e pakuptimtë, që ndodh mes dy shefave të qeverive, të cilët i përkasin të njëjtit komb, të ndarë në shtete të ndryshme. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Islami ka theksuar se kjo përplasje mes tyre nuk do të duhej të ndodhte. "As Haradinaj dhe as Rama nuk janë tradhtarë, por as Rama dhe as Haradinaj nuk e kanë në dorë të shesin pjesë të Kosovës, t'i ndryshojnë kufijtë apo ta përcaktojnë të ardhmen", ka thënë ai, duke shtuar se nëse kjo histori mes tyre do të vazhdojë, do të jenë që të dy të mundur, e faji do të jetë i përbashkët. Islami ka thënë se Kosova dhe Shqipëria duhet të kenë një platformë të përbashkët politike, ekonomike zhvillimore, arsimore, të kulturës, energjisë, të financave dhe të tregtisë



EPOKA E RE Mal QORRAJ

PRISHTINË, 27 JANAR - "Epoka e re": Z. Islami, kemi lexuar disa opinione tuajat rreth debatit të fundit në mes të kryeministrit të Kosovës, Ramush Haradinaj dhe atij të Shqipërisë, Edi Rama, për përplasjen që kanë pasur për temën e korrigjimit të kufirit në mes të Kosovës dhe Serbisë. Ky debat tanimë, përpos që vazhdon mes tyre, ka kaluar edhe në gjyq, pas padisë që ka bërë zoti Rama. Si e shihni këtë përplasje Haradinaj - Rama?

Islami: Është përplasja më e pakuptimtë që ndodh mes dy shefave të qeverive, të cilët i përkasin të njëjtit komb, të ndarë në shtete të ndryshme. Padyshim, duam a nuk duam, do të mbetet si një rast i shëmtuar dhe, në të njëjtën kohë, tragjik! I pamenduar më parë, shernaja mes dy shefave qeveritarë tregon se ende në politikën shqiptare mbizotëron ndjenja e tribusë, politika rurale është jo vetëm formë, por edhe përmbajtje. Mes shefave qeveritarë do të ketë kurdoherë përplasje për ide të ndryshme, vizione, mendime, perceptime politike e historike; do të ketë dallime dhe mirë është që të ketë. Por gjithnjë ata kanë hapësirën e tyre, një shtrirje që zë atë përmasë sa është e perceptueshme dhe nuk kalon në meritë, përcaktimet dhe, çfarë është më e rëndë, në gjyqet absurde. Nuk duhej të ndodhte. As Haradinaj dhe as Rama nuk janë tradhtarë, por as Rama dhe as Haradinaj nuk e kanë në dorë të shesin pjesë të Kosovës, t'i ndryshojnë kufijtë

apo ta përcaktojnë të ardhmen. Përplasja mes tyre tregon se ende është në botëkuptimin e shfaqur mëria politike, e cila, aq sa ka lidhje me Kosovën, aq ka lidhje edhe me Shqipërinë që, aq sa ka lidhje me ata personalisht, aq ka të bëjë edhe me aleancat politike në të dy vendet. Kombi nuk trajtohet si politikë, as si pjesore dhe, dy shefat qeveritarë kanë anashkaluar pikërisht këtë koncept.

"Epoka e re": Ky raport mes dy kryeministrave sa mund të ndikojë në raportet Kosovë - Shqipëri?

Islami: Në fakt, për fat të keq, do të ndikojë. Jo se këta dy shtetarë kanë forcën e ndikimit aq sa t'i ndryshojnë raportet, por ata që kanë qenë të gatshëm t'i keqësojnë këto marrëdhënie janë rizgjuar, kanë ngritur një botë tjetër, e kanë përgjithësuar sherrin mes dy shefave qeveritarë si një shernajë në mes të Shqipërisë dhe Kosovës. Pra, kanë ngritur një stuhi, e cila e ka derdhur kupën e saj dhe, momentalisht, duket se ka ndikuar. Është një gjendje e kalueshme, e përbalueshme dhe do të bëjë një ndarje mes atyre që e përballuan këtë sherr si një sherr mes kryeobanëve dhe atyre që menduan se kjo është zezonë. Në Kosovë këto janë të njohura. E kanë dashur këtë sherr dhe e kanë nxitur edhe para fillimit të një procesi gjyqësor. Për to, pikërisht për to, ky përbën lajm, është tragjedi, kanë vënë kujën dhe do ta vazhdojnë këtë kujë. Këta janë njerëz të njohur, më shumë të tubuar rreth disa mediave që kurrë nuk e kanë

dashur afrimin e Kosovës me Shqipërinë, se tek njerëzit e politikës. Politika në Kosovë, ndoshta edhe nga momenti i tashëm, u tregua më pragmatike, e heshti këtë përplasje, nuk e bëri pjesë të lojës së saj.

Në Shqipëri klasa politike, njerëzit e politikës e priten këtë rast për ta dëshmuar patriotizmin e tyre dhe për t'iu vërsulur edhe një herë njëri-tjetrit. Të gjithë po tundin flamurin e atdhedashurisë, si të jetë monopol i tyre. Është e përkohshme. Përgjithësisht njerëzit e njohin këtë klasë politike që ka uzurpuar shtetin, e dinë se sa atdhetarë kanë qenë e janë. Po të ishin vërtet aq patriotë sa shfaqen tani, apo aq modernë sa duan të dëshmojnë, do të kishim pasur një Shqipëri ndryshe, një Kosovë ndryshe, raporte të tjera, do të kishim tregti të përbashkët, politika të përbashkëta arsimore, hapje kufijsh, zhvillime shkencore të përbashkëta. Nuk kemi asnjëherë prej tyre. Mentaliteti se "më mirë i pari në katund, se i dyti në qytet", duam apo jo, është ende real në politikën shqiptare. Tjetër ndikim nuk ka dhe nuk do të ketë. Është ngritur një stuhi e përkohshme, e cila nuk do të zgjasë shumë dhe nuk do të ketë pasoja të mëtejshme.

"Epoka e re": Si e shihni ju kapërcimin e këtij debati, fundin?

Islami: Jam i bindur se e gjithë

kjo do të shuhet shumë shpejt dhe ata që do të mbeten të rënduar nga kjo histori do të jenë dy shefat qeveritarë. Nuk besoj se do të ketë gjyq. Si shumë gjëra të tjera, do të harrohet. Ata, Rama dhe Haradinaj, kanë gabuar të dy. Asnjëri prej tyre nuk është i fituar. Nëse kjo histori do të vazhdojë, do të jenë të dy të mundur. Faji do të jetë i përbashkët.

Shikoni, është e vërtetë se Rama dhe Haradinaj janë dy njerëz me karaktere të ndryshme, rrugëtim të ndryshëm politik, aq sa kanë qenë miq, aq edhe janë të larguar nga njëri-tjetri. Rama erdhi në politikë nga Parisi ku ishte i mërguar. Një rast fatkeq i familjes së tij përcaktoi edhe rrugëtimin e tij politik. Nga i djalhtë ekstrem, u bë drejtuesi i së majtës. Ai ka përcaktimin se "PS nuk ma la Fatos Nano, por ia mora Fatos Nanos", duke e trajtuar si një përlëshje, e cila, herë është zbutur dhe herë të tjera ka kaluar në grotesk, për të shkruar rishtas drejt përplasjeve. Haradinaj ka qenë pjesë e një lëvizje klandestine çlirimtare, në të cilën ka bërë pjesë e gjithë familja e tij. Rama, në të njëjtën kohë kur pjesë të familjes Haradinaj ishte e burgosur, mes të cilëve shquhej Smajl Haradinaj, ishte pjesë e një nomenklature të nivelit mbi të mesmen, por kundërshtar dhe përtallës i nomenklaturës së lartë, me gjithë sistemin që

mishëronte ajo.

Haradinaj hyri në politikë nga lufta, Rama nga vizatimet. I pari humbi dy vëllezër në luftë, i dyti, sapo u bë kryeministër, thirri në Shqipëri vëllanë e tij në ShBA. Unë kam punuar me Ramush Haradinaj, kemi qenë pjesë të së njëjtës organizatë politike, por edhe më pas; ai është pasionant në punë, nuk e njeht kufirin politik mes së majtës dhe të djathtës, e kërkon dhe e do pushtetin. Rama është më i artikuluar, koha e tij ka rrjedhur ndryshe, pikëpamjet e tij janë të moderuara, por duke shkruar drejt liberalizmit të pafund financiar, ka krijuar tani e, më pas, edhe më shumë, një greminë financiare. Haradinaj si njeri është i besuar, kurrë nuk e kam kthyer kokën, mendoj si njeri i politikës, kur jam ndarë me të, ai ka miq të shumtë që do t'i ketë edhe kur të mos jetë në politikë. Rama, sipas bindjes sime, nuk ka miq, rënia e tij nga politika do të jetë edhe vetmia e tij njerëzore; oligarkët do ta lënë në vetminë e tij, por edhe ata që sot besojnë verbërisht tek ai, qoftë në Kosovë apo në Shqipëri, një ditë mund të genden të larguar nga miqësia e tij. Kanë edhe të përbashkëta. Që të dy janë njohës të mirë të gjuhëve të huaja. Në gjuhë të huaj merren vesh më mirë se në gjuhën shqipe, kjo figurativisht. Haradinaj flet shumë mirë disa gjuhë, mes të cilave anglisht, gjermanisht, italisht,

nuk do të duhej të ndodhte



finlandisht, serbo-kroatisht, ndërsa shqipja e tij është ende okale, e Rrafshit të Dukagjinit e, po ashtu, edhe Rama flet shkëlqyeshëm mjaft gjuhë të huaja. Unë kam bindjen se të dy e duan Shqipërinë dhe Kosovën, nuk kanë ndërmend as ta shesin dhe as ta copëtojnë dhe, e gjithë kjo që ndodhi, më shumë sesa mendësi politike e Kosovës, ka fillësën në Tiranë. Sherrnaja e Tiranës zbriti në Prishtinë në këtë formë amorfe, të pabukur dhe të padenjë. Nëse nuk do të merren vesh në gjuhën shqipe, ku Rama është mjeshtër i vërtetë, një ditë, nëse Haradinaj do të ishte kryeministri i Kosovës, do të ishin marrë vesh në anglisht, pra një fuqi ndërkombehtarë, anglishtfolëse, do t'i kishte ulur përballë njëri-tjetrit, do t'i kishte mbyllur në një dhomë dhe do t'u thoshte se nuk do të dilnin jashtë saj pa u kuptuar me njëri-tjetrin. Ne, shqiptarët, merremi vesh më mirë jo në gjuhën shqipe.

"Epoka e re": Ku mendoni se duhet të forcohet më shumë bashkëpunimi Kosovë - Shqipëri?

Islami: Kudo mund e duhet të forcohet, në të gjitha fushat. Jemi të vonuar, madje shumë. 20 vjet pas çlirimit të Kosovës hapat që janë bërë janë të vegjël, pak të dukshëm dhe, edhe më pak efektivë. Pas ngjarjeve të vitit 2001, pranverën e këtij

viti, shteti serb ngriti një strukturë të posaçme, të përbërë nga pak politikanë, por më të shumtën akademikë, profesorë të njohur, gjeologë, ekspertë të njohur të sigurisë, hartografë etj. për ta shkundur shtetin e Kosovës që po vinte në hartën politike të Evropës. Programi i tyre është aq i detajuar sa nuk janë harruar as imtësitë më të vogla. Për shembull, njëri prej tyre është dhe çmitizimi i familjes Jashari, vendi ku nisi rrokullisja e tyre.

Kosova dhe Shqipëria nuk kanë ende një platformë të përbashkët, kur kjo duhej të kishte filluar të ngrihej që në vitin 2000. Nuk kemi një platformë të përbashkët politike, ekonomike zhvillimore, arsimore, të kulturës, energjisë, të financave, të tregtisë. Akademikët tanë, duke risjellë ndërmend një thënie të Hamzë Jasharit, i kanë futur veshët në lesh.

Ne një kohë jo të largët në Kosovë ishin idhuj të atdhedashurisë akademikë të shquar si Çabej, Buda, Kostollari, Uçi, Kadare, Agolli, Demiraj, Mejdani etj., në Shqipëri njerëzit vraponin për të takuar Idriz Ajetin, Anton Çetën, Rexhep Qosjen, Ali Hadri ishte një shëmbëlltyrë politike dhe atdhedashurie; me gjithë ndarjen politike përsëri kishte programe të përbashkëta.

Sot pak veta i njohin akademikët e Shqipërisë në Prishtinë dhe aq më pak akademikët e Kosovës në Tiranë. Duhet përmbysur këto raporte. Më së pari, duhet krijuar një komitet i përbashkët, që të ndërtojë strategji të përbashkëta, të detyrueshme për t'u zbatuar nga dy qeveritë. Nëse ndodh kjo, atëherë shefat qeveritarë nuk do të kenë kohë të zihen me njëri-tjetrin dhe të kënaqen duke gjetur epitete të pahijshme.

"Epoka e re": Dalim pak edhe të situata e fundit në Kosovë, zgjedhjet e 6 tetorit të vitit të kaluar dhe mundësia për krijimin e institucioneve në Kosovë. Sipas jush, pse gjithë kjo vonesë në krijimin e qeverisë së re, kur kemi parasysh zotimet e LV-së dhe të LDK-së se menjëherë pas 6 tetorit do t'i formojnë institucionet. A mund të arrihet një koalicion mes këtyre dy partive apo opsion shihni një qeveri teknike apo shkuarje në zgjedhje të reja?

Islami: Në politikë, më shumë se kudo, hesapet e shtëpisë nuk dalin në pazar. Përbetimet parazgjedhore harrohen. Fillojnë llogaritë e ftohta, duke synuar secila të jetë në rolin e luanit. Por, askush nuk dëshiro

ron të jetë nën këmbët e tij, aq më tepër LDK-ja, një forcë politike që është mësuar të bëjë llogari të ftohtë dhe mungesën e një lideri si Rugova ta zëvendësojë me krijimin e forcave të tjera. LDK-ja bën dhe ka bërë gjithnjë llogari gjakftohta. Ajo nuk të jep gishtin pa e ditur se të merr krahun. Nga ana tjetër, nuk e kam menduar se edhe LV-ja do të jetë kaq naive, e përciptë dhe momentale. Jam prirë gjithnjë të besoj se lideri i saj i padiskutueshëm, në fakt lideri më i lexuar që është në Kosovë, do të dijë ta gjejë mesoren e artë, pa e dëmtuar Lëvizjen e tij por, mbi të gjitha, pa e dëmtuar Kosovën. Bashkimi mes LV-së dhe LDK-së do të jetë i vështirë por, edhe nëse bëhet, do të jetë i mundimshëm. Ëndërrimtarët e LV-së nuk mund të jenë në një kohë të gjatë dhe të suksesshme me pragmatikët e LDK-së, kur kjo e fundit ka një fillësë krejt ndryshe politike nga ajo e LV-së. Kam besuar se Albin Kurti do të dalë nga stanjacioni, jo përmes një loje të lexuar dhe të pabukur politike por, si kam pritur, përmes arsyes së dukur, qëndrimit të fortë dhe mendimit racional. LDK-ja, por edhe ai

vetë, e futën në një lojë, me dhimbje e them këtë, që nuk është e denjë për figurën e tij, sidomos për figurën e pritur. Unë, personalisht, do të isha për një qeveri teknike, gjithëpërfshirëse, të kufizuar në kohë, të themi njëvjeçare, që do t'i përgatiste zgjedhjet e reja, por në të cilën të mos përfshihej PDK-ja, e cila ka zgjedhur rrugën e qëndrimit në opozitë dhe mendoj se duhet të jetë në opozitë. Ajo duhet ta shërojë veten për të qenë pjesë e shërimit të plagëve të Kosovës.

"Epoka e re": Dhe një pyetje për fund. Këto ditë që për vizitë në Kosovë dhe Serbi i dërguari i posaçëm i ShBA-së për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell, pas arritjes së marrëveshjes për linjën ajrore Prishtinë - Beograd, e cila mori përkrahje nga liderët në Kosovë, por që u kundërshtua nga shoqëria civile për mungesë transparence. Kjo vizitë e Grenellit, a mund të cilësohet si presion për arritjen e shpejtë të marrëveshjes finale Kosovë - Serbi?

Islami: Së pari marrëveshja finale Kosovë - Serbi është ende larg. Më larg nga sa mund të mendohet, pasi problemet mes

dy shteteve janë të shumta, të rënda dhe që ende nuk kanë filluar të kenë kahun e zgjidhjes. Histori tragjike qëndrojnë ende pezull dhe, si duket, qeveria serbe as që mundohet të ketë zgjidhje. Në të kundërtën, ajo po bën gjithçka është e mundur për ta përmbysur realitetin e shtetit të Kosovës. Nga ana tjetër, së dyti, nuk është thjesht presion, është dëshirë e ShBA-së për të gjetur një zgjidhje dhe çdo administratë e lartë amerikane, edhe kjo e sotmja, kërkon të ketë një sukses, zgjidhje. Mendoj se është një fillësë e re e qëndrimit të njohur amerikan. Nga ana tjetër, e gjithë kjo marrëveshje ishte në një tis të thellë fshehtësie, sikur të kishte një ndjenjë frike se do të pengohej. Ende nuk dihet asgjë rreth negociatave për të, ashtu si nuk dihet asgjë për një marrëveshje të re në ndërlidhjen hekurudhore. Kosova është një moment kyç, ndoshta nga më të rëndësishmit në periudhën pas pavarësimit të saj. Së shpejti, mendoj, do të ketë ngjarje që mund të tronditë skenën politike. A do të përballohet ajo? - këtë do ta dëshmojnë muajt në vazhdim, por unë jam i bindur se po.



Në Klinë arrestohen tre persona të dyshuar për 'vjedhje të rëndë'

PEJË, 27 JANAR (ER) - Policia e Kosovës, konkretisht Njësi i Hetimeve pranë Stacionit Policor në Klinë, më 27 janar, rreth orës 04:40, ka qenë duke zhvilluar

patrullime, me ç'rast ka hasur tre persona të dyshuar, të cilët, kur e kanë vërejtur patrullën, kanë ikur dhe, pas dhjetë minutave, hetuesit policorë kanë arritur t'i arresto-

jnë. Të dyshuarit e arrestuar janë shtetasit: P. D., i lindur më 1992, m/k/sh, S. LL., i lindur në vitin 2000, m/k/sh dhe P. P., i lindur më 1986, m/k/sh. Personat e arrestu-

ar janë të dyshuar për disa vepra të vjedhjes së rëndë në Klinë. Të dyshuarit, pas intervistimit, me urdhër të prokurorit janë ndaluar për 48 orë.



Malisheva ka tejkeluar realizimin e të hyrave vetjake për 5.5 për qind

MALISHEVË, 27 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, e ka mbajtur të hënën mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve, ku drejtorët e drejtorive kanë raportuar për planet dhe aktivitetet e tyre gjatë javës së kaluar dhe planifikimet për javën në vijim, si dhe janë trajtuar edhe çështje të tjera që lidhen me obligimet e ekzekutivit në Komunën e Malishevës. Gjatë raportimit të tij drejtori për buxhet dhe financa, Valon

Mazreku, ka konfirmuar se të hyrat vetjake të komunës, bazuar në planifikim, janë tejkeluar për 5.5 për qind, apo shprehur në mjete, janë grumbulluar rreth 47 mijë euro më shumë se planifikimi.

Mazreku ka thënë se shumë shpejt do të përfundojë edhe raporti i tërësishëm i të hyrave dhe shpenzimeve të buxhetit për vitin e kaluar.

Sa i përket situatës në fushën e shëndetësisë, drejtori për

Shëndetësi, Liridon Hoti, ka thënë se si rezultat i gripit sezonal është shtuar numri i pacientëve të cilët kërkojnë trajtim mjekësor në qendrat shëndetësore, por nuk ka ndonjë shqetësim dhe shërbimet shëndetësore janë duke u kryer normalisht.

Në këtë mbledhje është diskutuar edhe për çështje të tjera që lidhen me punët, aktivitetet dhe obligimet e ekzekutivit, ndërsa të gjitha shërbimet komunale janë duke u kryer pa problem.



Gurthyes në fshatin Buçë vazhdon të jetë shqetësues për banorët



DRAGASH, 27 JANAR (ER) - Në tryezën e organizuar nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) është diskutuar çështja e operimit të gurthyesit në fshatin Buçë, ku pjesëmarrës ishin zyrtarët e Komunës së Dragashit, nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), nga Komisioni për Minerera dhe Minerale si dhe banorët e fshatit. Banorët e fshatit Buçë kërkuar përgjegjësi nga niveli qendror dhe lokal rreth pëlqimeve dhe lejeve që i janë dhënë operatorit të gurthyesit në fshatin Buçë. Përfaqësuesi nga MMPH ka thënë se operatori në fjalë ka lejet dhe pëlqimin për të operuar në këtë lokalitet, vendime këto të cilat janë paraprirë nga një disku-

tim me banorët e këtij lokaliteti. Megjithatë, banorët kanë shprehur shqetësimet e tyre rreth operatorit të gurthyesit, duke kërkuar nga niveli komunal të ketë inspektime të rregullave për respektim të kriterëve në bazë të lejeve dhe pëlqimit që është dhënë.

Ndër rekomandimet kryesore të dalta nga kjo tryezë mbetet rregullimi i orarit të punës nga gurthyesi, inspektimi i rregullt nga niveli komunal, matja e ndotjes së ambientit dhe zhurmës akustike nga MMPH-ja.

Takimet janë realizuar në kuadër të projektit "Rritja e llogaridhënies së institucioneve të qeverisjes lokale", që mbështetet nga Ambasada Britanike në Prishtinë.

Ramosaj mbledh Këshillin e Drejtorëve në takim konsultativ

DEÇAN, 27 JANAR (ER) - Kryetari i Komunës së Deçanit, Bashkim Ramosaj, ka mbajtur takim konsultativ të Këshillit të Drejtorëve, ku është diskutuar për çështje të ndryshme.

Në takim u diskutua për mbledhjen e radhës të Kuvendit Komunal të Deçanit, aktivitetet e prokurimit, punët të cilat janë në përfundim e sipër si

dhe është bërë shqyrtimi i kërkesave të qytetarëve nga kryetari dhe drejtorët. Takimi i radhës i Këshillit të Drejtorëve do të mbahet javën e ardhshme.



Policia në Prishtinë bastis një lokal që jashtëligjshëm ushtronte veprimtari bixhozi

PRISHTINË, 27 JANAR (ER) - Më 25 janar 2020 njësitet e Stacionit Policor Veriu në Prishtinë, të mbështetura nga njësitë e Drogës dhe Administratës Tatimore të Kosovës, kanë kryer një bastisje në një lokal në rrugën "Bajram Bahtiri" në Prishtinë. Lokali është bastisur

nën dyshimin e bazuar për veprën penale "Organizim i skemave piramidale dhe bixhozit të paligjshëm", vepër për të cilën është arrestuar një person i dyshuar. "Gjatë këtij operacioni janë sekuestruar, në cilësinë e provave materiale, tri shtëpiza kompjuteri, pesë monitorë, një

printer si dhe gjësende të tjera që mund të shërbejnë si dëshmi për rastin në fjalë. Aktualisht hetuesit policorë janë duke kryer procedurat e nevojshme para se rasti të kalojë në institucionet kompetente", është thënë në njoftimin e Policisë së Kosovës.



Kosova përkujton viktimat e Holokaustit

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 JANAR - Liderët e institucioneve të vendit dhe liderët e partive politike kanë përkujtuar Ditën Ndërkombëtare të Holokaustit. Ata në deklarimet e tyre kanë theksuar se në këtë ditë Kosova i bashkohet kujtimit për viktimat e Holokaustit, një krim gjenocidal dhe monstruoze që tmerroi gjithë botën.

Presidenti i vendit, Hashim Thaçi, ka thënë se pas Luftës së Dytë Botërore u mendua se vuajtjet e miliona njerëzve të vrarë mizorisht do ta shndërronin Holokaustin në një krim të papërsëritshëm për njerëzimin. "Por, ideja dhe përpjekjet për shfarosjen e njerëzve dhe etnive u vazhduan edhe nga regjimi i Serbisë në Bosnje e Hercegovinë dhe në Kosovë. Masakrat dhe spastrimi etnik u ngjanin atyre të Luftës së Dytë Botërore. Dhe, fatkeqësisht, Serbia edhe sot vazhdon t'i mohojë krimet që shkaktuan holokaustin ballkanik në këtë pjesë të Evropës", ka thënë Thaçi.

Ndërkaq, kryeministri në detyrë i Kosovës, Ramush Haradinaj, bashkë me kabinetin qeveritar kanë bërë homazhe te pllaka përkujtimore për hebrejtë, në shënim të Ditës Ndërkombëtare të Përkujtimit të Holokaustit. "Në nderim të njerëzve që kanë humbur jetë, të hebrejtë në Luftën e Dytë Botërore, në përkujtim të tragjedisë më të madhe të njerëzimit, në emër të qeverisë, të popullit të Kosovës, vendosa lule dhe bëmë nderim te memoriali kushtuar Sinagogës së

fundit që ka ekzistuar këtu në Kosovë", ka thënë Haradinaj, duke shtuar se kjo po bëhet në respekt edhe të trashëgimisë e kulturës, por edhe tragjedisë njerëzore që ka ndodhur.

Ai ka thënë se duke i nderuar të gjithë ata njerëz të pafajshëm dhe duke përkujtuar gjithë atë tragjedi, sigurohen që tragjeditë e tilla të mos përsëriten. "Për fat të keq edhe populli i Kosovës e ka përjetuar një tragjedi të madhe, të përmasave të jashtëzakonshme dhe ne bashkëndiejmë me të gjithë ata që tragjeditë kanë kaluar nëpër jetët e tyre", ka thënë Haradinaj.

Edhe ministri në detyrë i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka përkujtuar viktimat e Holokaustit. "Sot në Ditën Ndërkombëtare të Kujtimit të Holokaustit ne përkujtojmë miliona viktimat të pafajshme të Holokaustit në të gjithë Evropën. Shqiptarët janë krenarë që kanë ndihmuar hebrejtë në Luftën e Dytë Botërore për t'i shpëtuar të keqes përmes besës sonë. Ne duhet të synojmë që asnjëherë të mos ndodhin krime të tilla dhe gjithmonë besën tonë për njerëzimin. Në këtë ditë mendimet tona janë për viktimat e krimeve masive në Kosovë dhe më gjerë", ka shkruar Pacolli në llogarinë e vet në "Facebook".

Edhe kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka përkujtuar tmerrin e hebrejtë gjatë holokaustit duke uruar që kurrë të mos përjetohen ngjarje të tilla tragjike as nga hebrejtë e as nga ndonjë popull tjetër. Ai ka thënë se ne shqiptarët e dimë, fatkeqësisht, si është të jesh i padëshiruar, etni e

dorës së dytë, që mund të përndiqet, dhunohet, shkatërrohet, zhduket, me urdhër nga pushtete e shtete të cilat vrasin një popull në emër të një populli. "Sot përkujtojmë me dhimbje tmerrin e hebrejtë gjatë Holokaustit, me dëshirën që kurrë të mos përjetohen ngjarje të tilla tragjike, as nga hebrejtë e as nga ndonjë popull tjetër. Ne shqiptarët e dimë, fatkeqësisht, si është të jesh i padëshiruar, etni e dorës së dytë, që mund të përndiqet, dhunohet, shkatërrohet, zhduket, me urdhër nga pushtete e shtete të cilat vrasin një popull në emër të një populli. Mbase ngjashmëritë në përvoja të dhimbshme historike bënë që para 8 dekadash shqiptarët të ruanin aq sa mundeshin hebrejtë që jetonin me ta, e të tjerët që përpiqeshin t'i iknin tërbimit nazist. Mbrojtja e viktimave nuk u bë për lavdi, as për falënderim por, thjesht, pse ashtu duhet. Ashtu është njerëzoria. T'i zbatosh urdhrat e pushtetit kundër asaj çka të thotë ndërgjegjja njerëzore, do të thotë ta shndërrosh veten në makinë, e pasojat e kësaj ishin fatale, në kohën e nazi-fashizmit, por edhe më vonë me gjenocidet afër nesh e te ne, njëherë në Srebrenicë, e pastaj në Reçak, Krushë, Mejë... holokausti, kjo ngjarje e pakrahueshme për nga tmerrin e dhimbja, ky kulm i poshtëm i aktivitetit njerëzor, duhet kujtuar përjetë, në Izrael e në gjithë botën. Në shenjë respekti për mbi 6 milionë viktimat, e në shenjë zotimi që secili nga ne, në hapësirën tonë të vogël e të përditshme, të dënojmë çdo jehonë të mentalitetit politik përjashtues të tjetrit, e sidomos ekstremin e vet që shkatërron e shfaros", është shprehur Kurti.

Veseli: Kombi ynë është krenar që ndihmoi hebrejtë në tragjedinë më të rëndë njerëzore

Duke kujtuar vdekjen e gjashtë milionë qytetarëve hebrej, kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, ka thënë se shqiptarët janë krenarë me shembullin fisnik të kombit tonë, i cili në momentet më të rënda të kësaj tragjedie njerëzore si pak të tjerë u vendos në anën e drejtë dhe të duhur të



historisë, duke ofruar strehë e mikpritje për hebrejtë e persekutuar anembanë Evropës. "Sot shënojmë Ditën e Përkujtimit të Holokaustit dhe bëjmë homazh për gjashtë milionë fëmijë, pleq, gra e burra hebrej, si dhe për të gjithë viktimat e tjera të vrarë në mënyrë mizore gjatë Holokaustit. Ne sot jemi krenarë me shembullin fisnik të kombit tonë, i cili në momentet më të rënda të kësaj tragjedie njerëzore si pak të tjerë u vendos në anën e drejtë dhe të duhur të historisë, duke ofruar strehë e mikpritje për hebrejtë e persekutuar anembanë Evropës. Këtë përvjetor e bën edhe më domethënës fakti që vetëm para pak ditësh familja Sharri nga Prizreni u nderua nga shteti i Izraelit

dhe Yad Vashem me certifikatën e nderit dhe dekoratën e 'Të Drejtëve ndër Kombe' për strehimin dhe shpëtimin e një familje herreje. Po ashtu, duhet thënë se pak popuj të tjerë mund t'i kuptojnë me dhembshuri aq mirë sa ne vuajtjet dhe pasojat e krimeve të përbindshme të kryera ndaj popullit hebre sepse edhe populli shqiptar i ka ende të freskëta në kurriz pasojat e gjenocidit dhe pastrimit etnik. Prandaj, kjo ditë duhet të shërbejë për të reflektuar mbi tmerret e së kaluarës, por edhe për të dënuar, sot e gjithmonë, çdo formë dhune apo urejtje që bazohet në racizëm, anti-semitizëm apo çdo lloj paragjykimi për përkatësi personale", ka thënë Veseli.

Meta përkujton Holokaustin: Gjenocide të tilla nuk duhet të ndodhin kurrë më

Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Përkujtimit të Holokaustit, ka thënë se sot përkujtojmë me nderim miliona viktimat të pafajshme të mizorisë së pashpirt të Holokaustit, në mënyrë që antisemitizmi, mungesa e tolerancës, bashkëjetesës dhe shkeljet e lirive e të drejtave të njeriut të mos përsëriten kurrë më. "Dy dekada më parë në zemër të Evropës ishim dëshmitarë të masakrave e spastrimit etnik dhe fetar në

Bosnje e Hercegovinë dhe Kosovë. Gjenocide dhe akte të tilla çnjerëzore ndaj kujtdo që i përket një feje, etnie apo kombësie ndryshe, nuk duhet të ndodhin dhe nuk duhen lejuar të ndodhin kurrë më në botën ku jetojmë. Krenar për kombin tonë, që në periudhën më të errët të njerëzimit, mbrojtja dhe mirëpriti mijëra hebrej të larguar nga vendet e tjera, duke mos dorëzuar asnjë të pushtuesit", ka shkruar Meta në llogarinë e vet në "Facebook".



Rrezikshmëri e ulët për coronavirusin në Kosovë



PRISHTINË, 27 JANAR (ER) - Ministria e Shëndetësisë është duke përcjellë me vëmendje zhvillimet në botë në lidhje me pneumoninë virale coronavirus. Lidhur me këtë çështje, ministri në detyrë i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka thirrur të hënën në takim krerët e institucioneve shëndetësore në Kosovë. Gjatë këtij takimi ministri Ismaili ka kërkuar nga të pranishmit informata rreth situatës së coronavirusit si dhe ka kërkuar nga të gjithë mekanizmat shtetërorë e institucionalë, që të

jenë në gatishmëri në rast të paraqitjes së ndonjë rasti të dyshimtë.

Drejtori ekzekutiv i IKShPK-së, prof. dr. Naser Ramadani, ka konfirmuar se në Kosovë nuk ka asnjë rast me coronavirus dhe se rrezikshmëria për këtë virus në vendin tonë është e ulët. Drejtori i ShSKUK-së, Basri Sejdiu, ka konfirmuar se si institucion janë të gatshëm për menaxhimin e rasteve evantuale dhe përcjelljen e situatës epidemiologjike. Drejtoresha e Klinikës Infektive, Lindira Ajazaj-Berisha, ka thënë

se tashmë ka bërë përgatitjet e nevojshme sa i përket repartit të izolimit në rast të paraqitjes të ndonjë rasti që do të ketë nevojë për masa izolimi.

Gjatë kësaj jave ministri Ismaili do të ftojë edhe Komitetin Nacional për sëmundje ngjitëse për të diskutuar për situatën dhe nivelin e gatishmërisë. Institucionet shëndetësore në Kosovë sigurojnë të gjithë qytetarët se janë duke marrë të gjitha masat adekuete, sipas rekomandimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë.

Vonesa për krijimin e qeverisë po u shkakton dëme të mëdha bizneseve

EPOKA
ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 27 JANAR - Vonesa për krijimin e qeverisë së re nuk po ndikon vetëm në buxhetin e vendit, mirëpo po shkakton dëme të mëdha edhe në uljen e besimit të bizneseve. Kështu ka deklaruar drejtori i Odës Ekonomike të Kosovës, Berat Rukiqi, në një takim me Shoqatën e Zejtarëve dhe Afaristëve "Esnaf" nga Prizreni, takim ky i cili është mbajtur për ta shqyrtuar mundësinë e një lidhje bashkëpunimi në përkrahje të sektorit privat.

Rukiqi ka thënë se në matjen e tremujorit të fundit të vitit 2019 është parë një bllokadë të biznesit, që ka ndikuar në uljen e konferencës së bizneseve. Sipas tij, krejt kjo ka ndodhur për shkak të zvarritjes së procesit zgjedhor dhe vonesave në krijimin e qeverisë së re. "Sa i përket vonesës, dua ta ritheksoj edhe një herë faktin që kemi vetëm efekte që lidhen me buxhetin apo me mundësinë që të ketë vonesa në miratimin e buxhetit, mirëpo kemi dëme shumë më të mëdha në vetë performancën e bizneseve që vërehen në muajt e fundit në indikatorin e matjes së këtyre bizneseve. I kemi rezultatet e para dhe nuk janë mjaft inkurajuese për tremujorin e fundit të vitit 2019, që ka ndikuar në uljen e besimit të bizneseve,

pikërisht nga bllokat e gjata, qoftë prej momentit kur janë shpallur zgjedhjet, pastaj edhe në finalizimin e rezultatit zgjedhor që do të duhej të kurorëzohej me krijimin e qeverisë së re", u shpreh Rukiqi.

Ai ka folur edhe rreth marrëveshjeve të fundit të proklamuar nga ndërmjetësi i presidentit, Donald Trump, me dialogun Kosovë - Serbi, ku tha se gjatë vitit 2013 kanë iniciuar një dialog teknik me Odën Ekonomike të Serbisë. Sipas Rukiqit, si tema kryesore janë diskutuar eliminimi i barrierave në përgjithësi, barrierave teknike që ekzistojnë dhe barrierave të tjera që pamundësojnë lëvizjen e lirë të mallrave, por edhe të njerëzve me Serbinë.

Ai ka shtuar se për shkak të zhvillimeve që pasuan nga obstrukcioni serb në shumë fusha të tjera dhe kur erdhi edhe momenti i vendosjes e taksës nuk ka pasur përparim. "Ne në vitin 2013 kemi iniciuar një dialog teknik me Odën Ekonomike të Serbisë. Në këtë dialog tri tema kryesore ishin: eliminimi i barrierave në përgjithësi, barrierave teknike që ekzistojnë dhe barrierave të tjera që pamundësojnë lëvizjen e lirë të mallrave, por edhe të njerëzve me Serbinë. Tema e dyta ishte e lidhur me infrastrukturën, transporti hekurudhor dhe linja ajrore. Ndërsa tema e tretë ka qenë pjesa e shër-



bimeve postare. Për shkak të zhvillimeve që pasuan nga obstrukcioni serb në shumë fusha të tjera që erdhi dhe rezultoi me vendosjen e taksës nuk ka pasur progres në atë kohë, mirëpo ne i kemi konsideruar si marrëveshje të një pako të përgjithshme që e mundësojnë lëvizjen e lirë të mallrave, të shërbimeve dhe të njerëzve mes Kosovës dhe Serbisë, normalisht

duke shfrytëzuar edhe infrastrukturën që do të ndërtojmë ndërmjet dy vendeve për lidhjen me korridoret e rëndësishme ndërkombëtare", ka deklaruar ai. Sa i përket takimit me përfaqësuesit e shoqatës "Esnaf", Rukiqi ka thënë se kanë bashkëpunim të mirëfilltë që shumë vite, duke shpresuar se ky bashkëpunim të vazhdojë edhe në vitet e ardhshme.

Kryetari i shoqatës "Esnaf", Varis Xhejlani, u shpreh se vizita e tyre në OEK ishte që ta shpërndajnë buletin e punuar për 25-vjetorin e kësaj shoqate. Xhejlani ka theksuar se ky buletin përmban informata të rëndësishme rreth zhvillimit ekonomik dhe turistik me qëllim që ta përcjellin traditën dhe kulturën e organizimit të "Esnaf"-it te brezat e ardhshëm.

Qendra e Trajnimeve të Telekomit do të zhvendoset në Prizren

EPOKA
ERE **A. MAVRAJ**

PRISHTINË, 27 JANAR - Telekomit i Kosovës dhe Ministria e Inovacionit kanë diskutuar të hënën për mundësinë e zhvendosjes së Qendrës së Trajnimeve në Prizren në Qendrën Inovative të Qeverisë së Kosovës. Ky diskutim u bë në takimin që pati kryeshefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Bedri Istrefi, me ministrin e Inovacionit, Muzafer Shala. Gjithashtu, në këtë takim është diskutuar që Telekomit t'i komercializojë programet e veta të trajnimit që janë gjithsej 74. "Bashkë me ministrin Shala diskutuam për mundësinë që këto trajnime t'ua ofrojmë të gjithë qytetarëve tanë ngaqë ne si kompani publike kemi obligim që të ofrojmë shërbime kualitative me çmimet më të mira në treg. Ndër trajnimet më të

rëndësishme që Telekomit do të ofrojë janë ato të CISCO-s dhe MICROSOFT", ka thënë kryeshefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Bedri Istrefi.

Ndërkaq ministri i Inovacionit, Muzafer Shala, ka pohuar se është shumë i rëndësishëm orientimi strategjik që Telekomit ka vendosur ta ndjekë. "Gjithashtu, është jashtëzakonisht me rëndësi kur menaxhmenti e di saktë se çfarë dëshiron të arrijë dhe, sa mësova nga takimi me z. Istrefi, këto dy veprime janë të qarta për ta dhe nuk dyshoj që do të arrijnë suksesin që synojnë", është shprehur Shala.

Ai ka bërë thirrje që kompania në fjalë të mbështetet nga institucionet vendore.

Në anën tjetër marrëveshja për shfrytëzimin të hapësirës së Qendrës Inovative do të nënshkruhet shumë shpejt.



Kosova dhe Serbia diskutuan në Berlin për rihapjen e linjës hekurudhore

EPOKA ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 27 JANAR - Ekipet teknike të Kosovës dhe Serbisë kanë zhvilluar të hënën një takim në Berlin për ta rihapur linjën hekurudhore ndërmjet tyre. Diskutimet për një marrëveshje të re për linjën hekurudhore ndërmjet Kosovës e Serbisë pasuan nënshkrimin e një marrëveshjeje midis dy vendeve për rihapjen e linjës ajrore Prishtinë - Beograd, me ndërmjetësimin ambasadorit amerikan Richard Grenell, i dërguar i presidentit Donald Trump për bisedimet e paqes ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ambasadori Grenell, gjatë vizitës që zhvilloi javën e kaluar në Prishtinë dhe në Beograd, ka thënë se për këtë tashmë ekziston një marrëveshje në parim. Bazuar në vendimin e ministrit në largim të Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, pala e Kosovës në Berlin përfaqësohet nga Xhemë Veseli, drejtor i Departamentit dhe Infrastrukturës Tokësore, dhe Ramë Çupeva, drejtor i infrastrukturës rrugore. "Ndonëse

institucionet tona janë të gatshme në vazhdimësi për kontribut në stabilitet dhe fqinjësi të mirë, theksojmë se çfarëdo marrëveshjeje që do të arrihet, do të jetë vetëm sipas Kushtetutës dhe ligjeve në fuqi të Republikës së Kosovës", ka shkruar Lekaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Ndërkaq, kryeministri në largim i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se zbatimi i një marrëveshjeje të tillë do të marrë kohë më të gjatë për shkak të problemeve me infrastrukturën "Një marrëveshje me Serbinë nuk i bën asnjë dëm Kosovës. Janë qindra mijëra njerëz tanë që janë detyruar t'i bien nëpër Serbi, disa prej tyre tani e kanë alternativë edhe aeroplanin. Mund të jetë edhe treni një opsion, mirëpo nuk është ndonjë ofertë e mirëfilltë tash për tash. Edhe nëse ndodhë marrëveshja praktikisht është një infrastrukturë shumë e dobët, jo aq adekuate për përdorim", ka thënë Haradinaj. Ai ka hedhur poshtë pohimet se përpjekjet e fundit për të arritur marrëveshje teknike ndërmjet Kosovës e Serbisë janë një rinisje



e bisedimeve për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet tyre. Bisedimet ndërmjet Kosovës dhe Serbisë janë pezulluar që nga nëntori i vitit 2018 kur Prishtina u vuri tarifa prej 100

përqindësh mallrave serbe në shenjë kundërshtimi ndaj fushatës së Beogradit kundër shtetësisë së Kosovës. Beogradi kushtëzon rifillimin e bisedimeve me heqjen e tarifave,

ndërsa qeveria e deritashme, e udhëhequr nga Ramush Haradinaj, i ka rezistuar trynisë amerikane dhe evropiane për pezullimin apo heqjen e tyre.

Ministri Shala nënshkruan vendimin për ndërtimin e Zonës Ekonomike në Rahovec



PRISHTINË, 27 JANAR (ER) - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, në vazhdim të mbështetjes për bizneset e huaja dhe vendore, të hënën ka nënshkruar vendimin mbi dhënie të pëlqimit për themelimin e Zonës Ekonomike, respektivisht Parkut Industrial në Opterushë, Komuna e Rahovecit, duke u bazuar në faktin se kriteret e parapara me legjislacion në fuqi janë plotësuar.

Ministri Shala ka theksuar se janë parapara 34 hektarë që do të vendosen bizneset e huaja dhe vendore, duke ndikuar në rritjen e punësimit dhe zhvillimin ekonomik të vendit. "Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është duke krijuar mundësi për bizneset në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës, duke

ndërtuar zona ekonomike. Kjo zonë do t'u shërbejë bizneseve që të kenë hapësira sa më të mira për ta ushtruar veprimtarinë dhe numri i të punësuarve parashihet të jetë rreth 600 persona", ka thënë Shala. Ai ka pohuar se roli i ministrisë është krijimi i kushteve sa më të mira për bizneset, duke punuar shumë në fuqizimin e tyre që të jenë konkurruese.

Ministria e Tregtisë dhe Industrisë do ta financojë infrastrukturën e kësaj zone me rreth 3 milionë euro duke i kushtuar rëndësi zhvillimit ekonomik të vendit. Investimet nëpër komunat do të vazhdojnë me ndërtimin e zonave ekonomike dhe inkubatorëve, duke bërë që Kosova të jetë vend atraktiv për të bërë biznes.

Reduktohet norma e TVSh-së për importimin e kafshëve dhe shpezëve të gjalla

PRISHTINË, 27 JANAR (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka njoftuar se Ministria e Financave ka nxjerrë vendimet për reduktimin e normës tatimore nga 18 për qind në 8 për qind për kafshë dhe shpezë të gjalla. Sipas vendimit

19/2019, gjegjësisht vendimit 19-1/2019, reduktohet norma tatimore nga 18 për qind në 8 për qind për mallrat e importuara/furnizuar brenda vendit. "Reduktimet do të shfrytëzohen sipas pikës 1 të shtojcës numër 3 të Ligjit për Tatimin mbi Vlerën e

Shtuar, si në vijim: 1.1. Kodi tarifor 0101 - kuaj, gomarë, mushka; 1.2. Kodi tarifor 0102 - gjedhe të gjalla; 1.3. Kodi tarifor 0103 - derra të gjallë; 1.4. Kodi tarifor 0104 - dele dhe dhi të gjalla; 1.5. Kodi tarifor 0105 - shpendë të gjallë; dhe 1.6. Kodi tarifor 0106 - kaf-

shët e tjera të gjalla", thuhet në njoftimin e ATK-së. Pra, importimi dhe furnizimi brenda vendit i mallrave të përfshira në kodet tarifore të lartcekura i nënshtrohen normës së reduktuar të TVSh-së prej 8 përqindësh.



LUFTA PËR GLAUKUN DHE GRENELLI ANTE PORTAS!



**Behxhet Sh. SHALA -
BAJGORA**

Rroftë Glauku, poshtë Glauku: Glauk Konjufca u zgjodh kryetar i Kuvendit me vota edhe të LDK-së, posti që ishte ndarë pikërisht për këtë subjekt politik e që tani, së paku deri më sot, po e kërkon t'i rikthehet, ndonëse e ka votuar vetë. Në situata normale dhe në një vend normal kjo çështje do të konsiderohej e përmbyllur ditën që ka përfunduar votimi. Në Kosovën thuaja të pavarur dhe me sovranitet të dhunuar nga Beogradi dhe ndërkombe-tarët, ku asgjë nuk e ka as formën e as përmbajtjen e normalitetit, është krejtësisht e ligjshme dhe e pranueshme që t'i hani fjalët tuaja pasi që janë tuajat dhe nuk i nënshtroheni fare përgjegjësisë publike e për moral nuk diskutohet fare nëse i referohemi thënies se politika është kurvë, madje jo në kontekstin lokal, por edhe në atë të BE-së! Nëse vrasja e dukës Franc Ferdinand në Sarajevë ka shërbyer si pretext për fillimin e luftës së Parë Botërore, sikur që vrasja e Qazim Hoxhës nga andartët grekë ka shërbyer që Musolini t'i shpallë luftë Greqisë, Glauk Konjufca thuaja se po e luan të njëjtin rol, së paku sipas disa analistëve dhe atyre që kanë interesa të drejtëpërdrejta politike. Për këtë arsye po kërkohet koka (politike) e Glaukut në mënyrë që të shpëtohet situata duke u arritur marrëveshja për bashkëqeverisje midis fituesit të zgjedhjeve, LV-së dhe të dytit, LDK-së. Më shumë se tre muaj po negociohet për këtë marrëveshje dhe, sa po mendojmë se e pati puna, posti i kryetarit të Kuvendit po e kthen në pikën zero krejt këtë përpjekje. Isa Mustafa e ka shumë vështirë, më shumë po ka probleme me ata që duhet t'i binden në bazë të hierarkisë partiake, se me këta të LV-së. Albin Kurti nuk e ka asnjë problem sepse është shndërruar në ikonë apo totem adhurimi të LV-së dhe askush dhe askujt as që i bie ndërmend se mund apo se duhet të kundërshtohet qoftë edhe për ta plotësuar mozaikun formal të demokracisë.

Të gjithë po e ngrenë në qiell Glauk Konjufcën dhe nuk mbahet mend të jetë lavdëruar aq

shumë ndonjë politikan nga Kosova për së gjalli, përjashtuar këtu ata që e kanë lëshuar këtë botë e që janë lavdëruar vetëm ditën e ceremonisë mortore. Po këta e duan vdekjen politike të Glaukut, si uverturë për eliminim të ngadalshëm nga skena politike përmes degradimit të personalitetit të tij sikur që duan që, në këtë mënyrë ta dobësojnë LV-në si edhe vetë Albinin duke i vënë shpatën e Demokleut mbi fytin e tij. E kanë një arsytim, më shumë mitik se politik, duke e krahasuar me Abrahamin apo Ibrahimin që ka qenë në gjendje ta flijojë të birin e vetëm e që pastaj ia mundësuan ta zëvendësojë me një qengj. Gjak aty, gjak këtu! Këta që po e kërkojnë flijimin e Glauk Konjufcës, duke e krahasuar me qengjin flijues, në fakt duan që, në fund të fundit, Glauk Konjufcën ta shndërrojnë në një gomar politik i cili do t'i bartë në samar të gjitha mëkatet e dështimeve të deritashme të bisedimeve, jo për shtet, por ekskluzivisht për pushtet. Lufta për kokën e Glaukut po më ngjanë në betejën e Stalingradit ku vendosej fati në frontin e BRSS-së apo të Ivo Xhimas në Japoni. Edhe në Kosovë duket se Glauk Konjufca po del të jetë përcaktues për fatin e "Koalicionit të Shpresës", nëse do të bëhet apo do të dështojë e që, sipas meje, nuk është fare e vërtetë! Koalicioni do të bëhet, me apo pa Glaukun! Mendoj se në situatën në të cilën jemi, edhe për LV-në sikur edhe për LDK-në më mirë është që Glauku të mbesë kryetar i Kuvendit dhe të bëjë një zgjidhje tjetër aq më parë që livadhi është shumë i madh dhe ka për të gjithë! Merreni me mend, nëse do të shkarkohej Glauku apo edhe nëse detyrohet të japë dorëheqje e që është e njëjtë, brenda një viti do të kishim 5 votime për zgjedhje dhe shkarkim të kryetarit të Kuvendit. Po të ndodhë kështu, LV-ja dhe LDK-ja do të hynin në natologji dhe libër të Ginesit për kapje të shtetit përmes dhunimit të pushtetit. Ka të tjera kombinime, prandaj jam fuqishëm që Glauk Konjufca të mbetet kryetar i Kuvendit. Ndryshe nuk bën. Lërimi ju përrallat për balancim të pushtetit sepse në të gjitha fushat ku garohet; i pari është i pari, i dyti është i dyti dhe asnjëherë nuk mund të barazohen i dyti me të parin, prandaj të gjitha përpjekjet bëhen për vend të parë e jo për vend të dytë! Jam i sigurt dhe gjithmonë kam qenë i sigurt se marrëveshja midis LV-së dhe

LDK-së do të bëhet dhe të gjitha këto bisedime janë bërë (stërzgjatje e që mendoj se nuk është edhe aq shumë stërzgjatje) është bërë të sigurohet më shumë pushtet. Gjithashtu, mund edhe të gaboj. Mendoj se këta po e marrin pushtetin në kohën më të keqe të mundshme ku do të merren disa vendime të dhimbshme për Kosovën, ku as LV-ja e as LDK-ja nuk do të kenë mundësi të pengojnë në asnjë mënyrë! Do të detyrohen ta hanë kulaçin e gatuar nga Vuçiqi dhe Thaçi, me mëlmesa hetuese të rrugaçes së Brukselit, Federika Mogerinit, trashëgimtare e bareshës Ashton! Koalicioni LV-LDK do ta ketë një opozitë të fuqishme andaj duhet ta lëshojë topin në tokë dhe të luajë me të gjithë, kurse artilerinë e rëndë dhe kërcënueset orale duhet ta zëvendësojë me një ftesë për bashkëpunim nëse nuk duan ta kenë gjendjen sikur në Shqipëri!

Richard Grenell apo "magjistari" i Berlinit: Donald Tramp është president i ShBA-së dhe mik i ngushtë i ish-presidentit të Kosovës, Behgjet Pacolli. Kanë shumë gjëra të përbashkëta; biznesmenë të suksesshëm, shoumenë, të dashuruar pas së bukurës, qoftë edhe femër të jetë, humanistë të mëdhenj që ta marrin kafshatën nga goja për ta forcuar Perandorinë financiare dhe, mbi gjitha, e kanë të përbashkët inteligjencën e që nuk dallojnë aspak në këtë fushë. Ju kujtohet fakti se pasi Donald Tramp doli nga abdes-hanja në Uashington, njeriun e parë që e nderoi me një shtrëngim duarsh ishte presidenti ynë i famshëm, Behgjet Pacolli, e që është respektim i jashtëzakonshëm si për ish-presidentin, për këshilltarët që i ka dhe për të gjithë neve pavarësisht se nuk jemi të gjithë republikanë. Në çastet më të rënda për Amerikën dhe presidentin Tramp, përkrahjen më të fuqishme, në mos edhe vendimtare, e ka pasur nga dy figura emblematike kosovare pa të cilat politika ndërkombe-tare nuk ka kuptim, dy presidentët: Hashim Thaçi - Shima dhe Behgjet Pacolli - Gjeti, Sanço Panço dhe Rosinanti i ditëve tona. Presidenti Tramp e do fort Kosovën, prandaj i ka caktuar dy lojtarët më të fuqishëm, më të besueshëm, më inteligjentë, më të ndershmit dhe më të guximshmit: Metju Palmer dhe Richard Grenell. Metju Palmer kam përshtypje se i ka rënë mrizit, kurse Grenell po i tregon muskujt në një mjedis ku ka të

bëjë me raketikë politike, por të uritur për pushtet deri në grykësi, siç është puna e Kosovës. Behgjet Pacolli i ka dërguar një letër adashit Tramp ku i siguron se i tërë populli i Kosovës është në anën e Trampit, pavarësisht situatave dhe zhvillimeve. Kjo i duhet Trampit para zgjedhjeve ta paraqesë Kosovën si sukses personal të cilin nuk kanë mundur ta zgjedhin të gjitha shtetet e Bashkimit Evropian bashkë, bashkë me Tanzaninë dhe Rodezinë. Begja është mashtrues sepse nuk janë të gjithë kosovarët votues (që kanë të drejtë vote) dhe përkrahës të Trampit. Begja mund të flasë në emër të vetin dhe eventualisht në emër të Hashimit, por kurrë në emër timin! Ngutia e Trampit për ta zgjidhur çështjen e Kosovës, me çdo kusht dhe me çdo çmim, është në përputhje të plotë me thënien popullore, se "kush ngutet, përmutet"! Richard Grenell na e solli marrëveshjen për fluturime dhe në këtë mënyrë i bëri Kosovës një shërbim të madh sepse, pas kësaj marrëveshjeje Kosova do të detyrohet ta aktivizojë flotën ajrore prej 100 Boeing 737 që rrinin kot së koti në hangarët e Aeroportit "Adem Jashari". Pas kësaj marrëveshjeje, çdo ditë, së paku 50 Boeing 737 të Air Kosova do të fluturojnë për Beograd, kurse 50 të tjerë për Nish. Gjithashtu, pritet të formalizohet marrëveshja për hekurudha, me ç'rast 29 trena super-sonikë do të aktivizohen në relacionin Leshkoqiq - Leshak, ndërsa nja 11 të tjerë do të aktivizohen në relacionin Gjylekar - Merdar. Pritet, gjithashtu, që të nënshkruhet marrëveshja për lundrim të lirë të anijeve moçalike dhe tejoqeanike midis Kosovës dhe Serbisë. Për fillim do të funksionalizohet lundrimi nga Përroi i Isës me lumin e Tisës për të vazhduar me lundrim ekologjik dhe strategjik midis lumit me ujëra të zeza të Krenës nga Drenica me Danubin nga Sremska Mitrovica. Sigurisht se Grenelli është mirë i informuar se marrëveshja që ka funksionuar dhe funksionon më së miri midis Kosovës dhe Serbisë e që realisht i bashkon dy Mitrovicat, ndonëse formalisht, as nuk është nënshkruar e as nuk është ratifikuar, është ajo e bashkëpunimit nëntokësor (jo miniera e Trepçës) midis dy kozy nostrave, veriore dhe jugore. Marrëveshjet e Richard Grenellit, që po i nxjerrë nga cilindri që i mbulon dy koka (Vuçiqit dhe Thaçit), janë pjesë të një marrëveshjeje integrale,

të arritur më parë e që tash, nga "buldozeri" Grenell po i serviren si kontribut i Trampit të cilat nuk duhet dhe nuk kundërshtohen. Në takimin jopolitik të Grenellit me liderë politikë; Albin Kurti dhe Isa Mustafa ua bëri të qartë se do ta kenë përkrahjen vetëm nëse përkrahin propozimet e Trampit për marrëveshje përfundimtare. Grenell tha se ka ardhur për zhvillim dhe çështje ekonomike, hapje të reja të vendeve të punës dhe, si hap i parë në këtë drejtim u interesua se si përgatitet fasulja "Tavqe - gravqe" dhe specat në mazë. Krejtësisht qëllim jopolitik! Kosovës i janë prerë teshat dhe, mos u habitni se mund të ndahemi bythëcullak. Grenell po tregon përralla për zhvillim ekonomik në kohën kur shumica e të rinjve po e braktisin Kosovën. Kush do të investojë në Kosovë nëse nuk keni siguri politike, nëse nuk e shtrini sovranitetin në tërë territorin e saj për t'i zbatuar ligjet, nëse e keni integritetin territorial të ndarë me banditë të veriut dhe banditë të jugut dhe nëse nuk keni liri të lëvizjes. Kosova nuk duhet të barazohet me Serbinë në asnjë rrafsh dhe në asnjë kontekst, Kosova duhet të ndahet nga Serbia dhe duhet ta qeverisë veten në mënyrë që pastaj, në bazë të interesave, të ndërtojë një marrëdhënie dhe bashkëpunim me Serbinë! Nuk barazohet taksa 100 për qind për mallrat serbe me një fushatë çnjohjeje shantazhuere që po e bën, e ndihmuar nga Ministria për Punë të Jashtme e Kosovës. Kosova duhet të negociojë në baza të barabarta, jo të dëgjohet dhe zbatohet atë që e kërkon Vuçiqi, qoftë përmes BE-së apo ndonjë shteti tjetër. Si ka filluar Grenell të nxjerrë marrëveshje midis Kosovës dhe Serbisë e që Kosova informohet nga mediet apo gjatë seancave dëgjimore me Grenell dhe të tjerë, shpejt do të vijë një ditë kur më nuk do të ketë marrëveshje dhe do të thuhet se u arrit marrëveshja për normalizim të marrëdhënieve midis Kosovës dhe Serbisë, pa u zgjidhur asnjë çështje praktike në terren! Kjo vetëm do të shkaktojë tensione të reja dhe konflikt të pashmangshëm sepse nuk po arrihet një marrëveshje e drejtë poir një marrëveshje e imponuar!

P. s. Merruni me punë për çka keni fituar votat dhe që keni detyrim ndaj qytetarëve votues e mos u merrni me halla, dajallarë, teze, nipa dhe mbesa! Është komunikim shumë i ulët, i padenjë, me një fjalë!

Fizika dhe kimia simetrike, udhëtim drejt universit (11)

Magnetizimi i pllakave feromagnetike mbi polet e magnetit (β) dhe (δ)



Shkruan: Naim KRASNIQI, fizikan

Magnetizimi i pllakave të hekurit mbi polet e magnetit kërkon një qasje tjetër të kuptuarit. Së pari duhet kuptuar se si ndodh magnetizimi i pllakave të hekurit mbi polet magnetike. Por për t'i sqaruar edhe më thjesht duhet t'i kthehemi edhe një herë eksperimentit dy, me ç'rast theksuam se kur të vendosen pllakat e hekurit (a) dhe (b) mbi polet magnetike (β_1) dhe (δ_2) kemi një rritje të fluksit të fushës magnetike ($\Phi\beta$) dhe ($\Phi\delta$). Shiko figurën 15. Pasi mikrogrimca (β), (δ) dhe (μ) kanë nivel energjetik shumë më të vogël se grimcat elementare vetërigjeneratore pasi të burojnë nga këto grimca orientohen për të dalë nga polet magnetike (β_1) dhe (δ_2) të magnetit, kurse pasi të dalin nga këto pole formojnë fluksat e fushave magnetike simetrike ($\Phi\beta$) dhe ($\Phi\delta$). Pllakat e hekurit (a) dhe (b) kanë një nivel shumë të ulët energjetik, por në momentin kur vendosen mbi polet magnetike veprojnë njëkohësisht forcat tërheqëse dhe shtytëse në mes protoneve, elektroneve dhe neutroneve të magnetit simetrik dhe pllakave të hekurit në të dy polet magnetike (β_1) dhe (δ_2). Dipolet magnetike (β), (δ) dhe mikrogrimca (μ) kanë nivel energjetik ekstrem të lartë në krahasim me nivelin energjetik të protoneve elektroneve dhe neutroneve të pllakat e hekurit (Fe), dhe në momentin e parë të kontaktit kemi një ç'rregullim total të niveleve energjetike të protoneve elektroneve dhe neutroneve në të dy polet magnetike. Në këtë mënyrë një pjesë e nivelit energjetik kaq te protonet elektronet dhe neutronet e pllakave të hekurit (Fe), kështu që këto mikrogrimca nga pllakat e hekurit pasi ta pranojnë këtë energji kabjnë në mikrogrimca (β''), (δ'') dhe (μ'') por që kanë një nivel energjetik më të ulët se vetë grimcat (β), (δ) dhe (μ).

Mikrogrimcat sekondare (β'')

Protonet e materialeve feromagnetike kur ndodhen në fushën magnetike, apo në kontakt të drejtpërdrejtë me polet magnetike të një magneti apo elektromagneti,

pranojnë një pjesë të energjisë dhe kabjnë në një nivel energjetik më të lartë në vlerën (X) n i cili varet nga fluksi i fushës magnetike ($\Phi\beta$), ($\Phi\delta$) dhe ($\Phi\mu$). Në këtë rast protonet e pllakës së hekurit kalojnë në vetërigjenerator, dhe nga to burojnë mikrogrimca (β''). Niveli i energjetik i mikrogrimcave (β'') është shumë më i ulët se niveli energjetik i mikrogrimcave (β). Këto mikrogrimca (β'') burojnë nga poli magnetik (δ'') dhe shpërndahen në të gjitha anët. Por vlen të theksohet se këto mikrogrimca (β'') që burojnë nga poli (δ'') e materialeve feromagnetike në brendinë e tyre përmbajnë nga dy fusha magnetike, ($1\beta''$) dhe ($1\delta''$) që kanë drejtime të kundërta.

Mikrogrimcat sekondare (δ'')

Gjithashtu edhe elektronet e materialeve feromagnetike kur ndodhen në fushat magnetike, apo në kontakt me polet magnetike, pranojnë një pjesë të energjisë, dhe kabjnë në një nivel energjetik më të lartë në vlerën (y) n i cili varet nga fluksi i fushës magnetike ($\Phi\beta$), ($\Phi\delta$) dhe ($\Phi\mu$). Niveli i energjetik i mikrogrimcave (δ'') është shumë më i ulët se niveli energjetik i elektroneve të materialeve feromagnetike (δ). Këto mikrogrimca (δ'') burojnë nga poli magnetik (β'') dhe shpërndahen ngjashëm sikur mikrogrimcat (β'') në të gjitha anët. Por vlen të theksohet se këto mikrogrimca (δ'') që burojnë nga polet (β'') të materialeve feromagnetike në brendinë e tyre përmbajnë nga dy fusha antimagnetike. Kështu dipoli magnetik (δ'') përmban dy fusha antimagnetike ($1\delta''$) dhe ($1\beta''$) që kanë drejtime të kundërta.

Mikrogrimcat sekondare (μ'') ni

Ngjashëm sikur në dy rastet e mëparshme edhe fenomenet të neutronet kur pranojnë energji të caktuar nga fusha magnetike apo kontakti i drejtpërdrejtë me polet magnetike, e rrisin nivelin energjetik në vlerën (z) n. Në këtë mënyrë këto neutrone shndërrohen në vetërigjenerator, dhe fillojnë të prodhojnë mikrogrimca (μ''), të cilat ndryshojnë tërësisht nga mikrogrimcat (β'') dhe (δ''). Pasi neutronet janë neutrale, për shkak të nivelit të ulët energjetik të fenomeneve brenda strukturës së neutroneve, dhe rrotullimin e fenomeneve (ct) në drejtime të njëjta, nuk mund të quhen dipole magnetike. Por kanë mjaft ndikim të fushat magnetike, sepse e rrisin shpejtësinë e daljes nga të dy polet magnetike të pllakave të hekurit (β'') dhe (δ'') të mikrogrimcave (β'') dhe (δ''). Meqenëse këto mikrogrimca (μ'') nuk janë të ngarkuara, dhe nuk posedojnë fusha në vete, prapë se prapë duke pasur parasysh se në brendinë e tyre posedojnë elemente (-ax) dhe (-ay) të kundërta me fenomenet (ct) të protoneve dhe elektroneve, kur dalin jashtë polit magnetik (β'') i rrisin distancat e tyre me mikrogrimcat (β'') he (δ'').

Fusha antimagnetike simetrike

Fusha antimagnetike ishte sqaruar gjithashtu në botimet te (epoka e re 2019). Mirëpo pasi tani kemi të bëjmë me fushën magnetike simetrike, e cila buron nga të dy polet (β_1) dhe (δ_2) të magnetit janë të nevojshme disa plotësime që kanë të bëjnë me rrjedhjen e fluksit e

fushës antimagnetike simetrike. Në momentin kur pllakat e hekurit (a) dhe (b) vendosen mbi polet e magnetit (M) protonet, elektronet dhe neutronet nën veprimin fluksit të fushës magnetike ($\Phi\beta$) dhe ($\Phi\delta$), pranojnë energji dhe e rrisin nivelin energjetik të tyre. Në këtë rast këto protone, elektrone dhe neutrone kalojnë në grimca vetërigjeneruese. Duke u bazuar në mënyrën e magnetizimit artificial të magnetëve permanent që vendosen në fushën magnetike të solenoidit, shihet se mikrogrimcat që burojnë nga protonet, neutronet në njërin anë dhe elektronet në anën tjetër orientohen në drejtime të kundërta drejt poleve magnetike. Kështu që këtë për shkak të forcës tërheqëse dhe shtytëse, dhe niveleve të ndryshme energjetike, në mes mikrogrimcave (β), (δ) dhe (μ) që burojnë nga polet magnetike (β_1) dhe (δ_2), dhe mikrogrimcave (β''), (δ'') dhe (μ'') që ndodhen në të dy pllakat e hekurit (a) dhe (b), këto të fundit shndërrohen në pengesa të pakalueshme për fluksat fushave magnetike në të dy polet e magnetit. Në këto rrethana kur mikrogrimca (β), (δ) dhe (μ) ju pamundësohet dalja nga polet magnetike (β_1) dhe (δ_2) kjo ndikon në rritjen e presionit të brendshëm të tyre, i cili presion në një formë e vështirëson daljen e këtyre mikrogrimcave nga protonet, elektronet dhe neutronet vetërigjeneruese. Pasi efekti i rigjenerimit të këto grimca nuk mund të ndalet, kjo e rritë edhe më shumë nivelin energjetik të protoneve, elektroneve dhe neutroneve në (x,y,z) (n+n), të cilat jo që e ngadalësojnë procesin e rigjenerimit por e ngritin në një nivel më të lartë. Në këto rrethana, kur ndryshon niveli energjetik të këto grimca,

ndryshojnë edhe lloji i mikrogrimcave që burojnë nga to, si dhe shndërrohen në vetërigjenerues të mikrogrimcave (β'), (δ') dhe (μ') që kanë një nivel energjetik shumë më të lartë se mikrogrimcat (β), (δ) dhe (μ). Në këtë mënyrë mikrogrimcave (β'), (δ') dhe (μ') nuk u mbetet asnjë alternativë tjetër pos të dalin dhunshëm jashtë poleve magnetike, do të thotë të dalin nga pjesa anësore e magnetit, ashtu sikur është cekur edhe në botimet e ("Epoka e re" 2019). Në këtë mënyrë tërë fluksi i fushës magnetike nga të dy polet e magnetit sa e kishte lërën e $\Phi\beta\delta=4.9 \times 10^{-4}$ Wb rikthehet në fushën antimagnetike e cila e ka vlerën $\Phi\beta'\delta'=4.9 \times 10^{-4}$ Wb. Po të bëhet një krahasim me fluksin e fushës magnetike që buron nga sipërfaqja e pllakave të hekurit në vlerën e $\Phi\beta'\delta''=7.48 \times 10^{-5}$ Wb rezulton se fluksi i fushës antimagnetike është për 6.55 here më i lartë se fluksi i fushës magnetike.

Mikrogrimcat (β'), (δ') dhe (μ')

Mikrogrimcat (β'), (δ') dhe (μ') janë të ndryshme nga mikrogrimcat (β), (δ) dhe (μ) dhe (β''), (δ'') dhe (μ''), sepse protonet, elektronet dhe neutronet i prodhojnë këto mikrogrimca atëherë dhe vetëm atëherë kur polet e magnetit mbulojnë me materiale feromagnetike. Edhe pse këto mikrogrimca burojnë nga pjesa anësore e magnetit shpërndahen në të gjitha anët duke formuar një formë sferike rreth magnetit me një rreze të caktuar (R) e cila varet nga niveli energjetik i mikrogrimcave (β'), (δ') dhe (μ'), dhe kohës së qëndrimit të materialeve feromagnetike mbi polet magnetike. (VIJON)




Fig 15

Shteti Islamik kërcënon Izraelin me sulme

PRISHTINË, 27 JANAR - Grupi militant Shteti Islamik u zotua se do ta shndërrojë Izraelin në shënjestër kryesore të sulmeve të tij. Grupi publikoi të hënën një audio-mesazh online, i cili thuhet se transmeton zërin e zëdhënësit të tij, Abu Hamza al-Quraishi. "Sytë e ushtarëve të kalifatit, kudo që të jenë, janë ende në Jerusalem", tha al-Quraishi në

mesazhin prej 37 minutash. "Në ditët që vijnë, me dëshirën e Zotit, do të shihni se çfarë ju dëmton dhe çfarë do t'ju bëjë t'i harroni tmerret që i keni përjetuar", tha al-Quraishi. Radio Evropa e Lirë nuk e ka konfirmuar vërtetësinë e mesazhit. Në vitin 2014, Shteti Islamik ka shpallur të ashtuquajturin kalifat në disa territore të Sirisë dhe Irakut, ku ka kontrolluar gjithçka

- nga monedha deri te plan-programi mësimor. Nën presionin e operacioneve të kombinuara ushtarake, kalifati ka kolapsuar vitin e kaluar dhe grupi është shpartalluar. Ish-udhëheqësi i grupit, Abu Bakr Al Baghdadi, është vrarë në një sulm të forcave amerikane në Siri, po ashtu vitin e kaluar. Megjithatë, ekspertët nuk e përjashtojnë mundësinë që Shteti Islamik të rigrupohet.



Avokatët e presidentit Trump rifillojnë mbrojtjen e tyre në gjyqin në Senat

Presidenti Trump është duke u gjykuar në Senat për akuzën se bllokoj 391 milionë dollarë ndihma ushtarake për Ukrainën, ndërkohë që u përpoq t'i nxiste udhëheqësit ukrainas të hetonin rreth ish-nënpresidentit Biden si dhe një teorie tashmë të diskredituar se ishte Ukraina, jo Rusia, që ndërhyri në zgjedhjet e 2016-s në ShBA

WASHINGTON, 27 JANAR - Avokatët e presidentit Donald Trump rifilluan të hënën mbrojtjen e tyre në gjyqin në senat, ndërkohë që demokratët bënë përsëri thirrje për paraqitje dëshmitarësh. Thirrjet vijnë pas një njoftimi të gazetës "New York Times", sipas së cilës, presidenti Trump i ka thënë ish-këshilltarit të tij të Sigurisë Kombëtare, se dëshironte ta pezullonte ndihmën ushtarake për Ukrainën, derisa Kiev i të niste hetime rreth rivalit të tij demokrat Joe Biden. Gazeta njoftoi së pari të dielën për aludimet që përfshihen në një libër të ri të ish-këshilltarit të Sigurisë Kombëtare John Bolton, të cilat më vonë u konfirmuan nga media të tjera, ka njoftuar voa. Presidenti Trump është duke u gjykuar në Senat për akuzën se bllokoj 391 milion dollarë ndihma ushtarake për Ukrainën ndërkohë që u përpoq t'i nxiste

udhëheqësit ukrainas të hetonin rreth ish-nënpresidentit Biden si dhe një teorie tashmë të diskredituar se ishte Ukraina, jo Rusia, që ndërhyri në zgjedhjet e 2016-s në ShBA. Një akuzë tjetër është se presidenti pengoi Kongresin me përpjekjet për t'i minuar hetimet për veprimet e tij. Të hënën, duke komentuar në "Twitter", presidenti e hodhi poshtë versionin e Bolton siç ishte njoftuar nga mediat. "Kurrë nuk i kam thënë John Boltonit se ndihma për Ukrainën lidhej me hetimet ndaj demokratëve, përfshirë Bidenin dhe të birin e tij. Në fakt, ai kurrë nuk u ankua për këtë kur u largua nga detyra në mënyrë mjaft publike. Nëse John Bolton e thotë këtë, kjo është thjesht për të shitur një libër", shkruante presidenti Trump. Një avokate e Boltonit tha në një deklaratë se dorëshkrimi i



librit ishte dërguar në Këshillin e Sigurisë Kombëtare një muaj më parë për t'iu nënshtuar shqyrtimit, një procedurë standarde për informacionet e klasifikuara përpara se të bëhen publike. Anëtarët e Dhomës së Përfaqësuesve që shërbejnë si prokurorë në gjyqin kundër

presidentit Trump bënë një deklaratë ku përsërisnin thirrjet që Boltoni të thirret si dëshmitar, duke thënë se ai "ka informacion jetik që mund ta ofrojë". Shtëpia e Bardhë bllokoj disa zyrtarë aktualë dhe të mëparshëm të administratës që të dëshmonin para komision-

eve të Dhomës gjatë hetimeve përpara gjyqit, duke përfshirë Boltonin dhe shefin e stafit në detyrë të Shtëpisë së Bardhë Mick Mulvaney, me arsyen e privilegjit që gëzon ekzekutivi. Boltoni u largua nga posti i tij në shtator dhe tha këtë muaj se ai është i gatshëm të dëshmojë nëse Senati ia kërkon këtë.

Të mbijetuarit e Holokaustit vizitojnë kampin Aushvic

AUSHVIC, 27 JANAR - Liderët botërorë iu bashkuan të mbijetuarve të Holokaustit të hënën në Poloni për ta shënuar 75-vjetorin e çlirimit të kampit të Aushvicit nga forcat sovjetike, teksa antisemitizmi shënon rritje në botë. Më shumë se 1.1 milion persona, shumica prej tyre hebrenj, kanë vdekur nëpër dhoma gazi, nga uria, të ftohtë apo sëmundjet në Aushvic.

I ndërtuar nga Gjermania Naziste pas pushtimit të Polonisë më 1940, fillimisht për të burgosurit politikë të Polonisë, këto hapësira janë kthyer në qendra të zbatimit të planit të liderit të nazistëve, Adolf Hitlerit, për shfarosje të hebrenjve. Duke folur para nisjes së ceremonive të planifikuara për të hënën, David Harris, udhëheqësi i Komitetit Amerikan të Hebrenjve, ka thënë se grupet e

supremacistëve të bardhë, xhihadistët dhe të majtët ekstremë janë duke nxitur antisemitizëm në gjithë botën. "Hebrenjtë në Evropën Perëndimore mendohen dy herë para se të shkojnë në sinagogë ose para se të hyjnë në dyqane të hebrenjve", ka thënë ai për agjencinë e lajmeve "Reuters". Përveç të vrarëve në Aushvic, gjatë Holokaustit kanë vdekur rreth 6 milionë hebrenj.



'Epoka e re', legjendë atdhetare shqiptare për 20 vjet

2000 - EPOKA E RE - 2020



Nga: Ndue DODAJ

ME RASTIN E 20 VJETORIT TË LINDJES SË GAZETËS PRESTIGJOZE TË EPOPESË SË RE, TË KËSAJ GAZETE TË LAVDISHME TË UÇK-SË E TË MBARË SHQIPTARIZMËS.

I nderuar vellai jonë i përbashkët Muhamet Mavraj!

Të nderuar pjesëtar të stafit të kësaj gazette, si një gazetë që përfaqson zërin e vërtetë të popullit tonë të mrekullueshëm!

Të nderuar vëllezër e motra!

Në këtë përvjetor të 20-të të gazetës tuaj të lavdishme

por dhe heroike, të zërit kumbues të Legjendarit Adem Jasharit, Fehmi e Xhevë Lladrovci e të gjithë dëahmorëve dhe heronjëve të kombit e atdheut tonë të dashur do ta kish për dëshirë që tju uronte në këtë ditë të shënuar me mendje e me zemër, e këtë do ta bënte cdo shqiptar kudo që të ndodhej që nga Vlora në Shkoder, që nga Saranda në Dibër, që nga Tetova e Gostivari, që nga Plava e Gucia, që nga Tuzi e Ulqini, që nga arbëreshët e shqiptarët që banojnë në Amerike, Turqi, Gjermani e nga çdo vend i botës, ashtu si dhe unë do tju bëjë një urim zemre për këtë 20-vjetor të gazetës tuaj.

Eshtë një nder i veçantë e i jashtëzakonshëm për mua që dhe si një shok e dashamirës i madh i drejtuesit të kësaj gazetë të nderuarit Muhamet Mavraj i cili na i ka hapur

rrugët që shpesh here të botojmë artikuj të ndryshëm në këtë gazetë dritëmadhe që mundohet që të shkëlqejë e ndricojë rrugët në interes të popullit.

Me këtë rast ju falenderoj dhe ju uroj që mu dha mundësia për të shprehur nderimet e mirenjohjen time të thelle për gazetën tuaj simbol të Kosovës në vecanti e të shqiptarizmit në përgjithësi që ka marrë pëmasa të gjëra jo vetëm në Kosovë por dhe në Shqipëri dhe më gjërë deri në Amerikën e largët.

Jeni Ju i nderuari Muhamet Mavraj që me përkujdesjen tuaj drejtoni këtë gazetë kaq të dashur për popullin e kjo është vecse një mrekulli që dinë të bëjnë vetëm atdhetarë të mëdhenj sic jeni dhe Ju i nderuari e fort i respektuari Muhamet Mavraj, ndaj për këtë meritë ju përd-

hëndesi dhe ju uroj jo vetëm me zemër por dhe me shpirt. Muhamet Mavraj dhe Epoka e Re mua më ngjasojnë si një Pishtar i Parë dhe i vetëm që u bën ballë çdo rrebeshi dhe sjell dritë edhe në një tunel me errësirë.

Luftën që nisi nëpërmjet penës, pra me të shkruar që në ditët e para të lirisë Epoka e Re me drejtuesin e saj UNIKAL Muhamet Mavraj tek unë e tek të gjithë ato shqiptar që e duan atdheun, flamurin e popullin kur thotë Epoka e Re ka thënë Muhamet Mavraj dhe kur thotë Muhamet Mavraj ka thënë Epoka e Re.

Puna Juaj do të këndohet me çifteli, e do të ngrihet në monumente përjetësie dhe do të përkulemi me respect e konsideratë për punën përkushtuese e vitale që bëni për të gjithë shqiptarët.

Si sot e 20 vite më parë do

të niste udhën në shërbim të shqiptarizmit gazeta Juaj në drejtimin Tuaj i nderuar Muhamet, ku Ju nëpërmjet kësaj gazete jeni bërë një flamur guximi, flamur patriotizmi, flamur lufte, flamur fitoreje.

E nderuar gazetë Epoka e Re, i nderuar Muhamet Mavraj do të doja të thoja dhe një herë dhe shumë herë se ndjehem tepër i privilegjuar që sot tju uroj suksese të mëtejshme dhe frytet e kesaj pune titanike do të dini ti çoni vazhdimisht përpara me sukses të plotë për të qenë kështu si një Kështjellë e pathyeshmërisë.

Dihet kontributi Juaj e në veçanti i Muhamet Mavraj por ashtu siç dihet kjo dihet se gazeta Epoka e Re do te mbetet vazhdimisht e re dhe e patundur në sukseset e saj.

Suksese të përjetshme Gazetës Epoka e Re!



Pikëpamjet e profesor Rexhep Qosjes për Albanologjinë (2)

III. Ndhimesat në fushë të studimeve gjuhësore

Prof. asoc. dr. MYRVETE
Dreshaj-Baliu
Prof. dr. Begzad BALIU

Në fushën e kërkimeve dhe të studimeve gjuhësore, theksonte profesor Qosja, në projektin e tij - ndihet nevoja të vazhdojmë mbledhjen e leksikut dhe të frazeologjisë popullore, (...) dhe si përfundim i kësaj pune duhet të dalin fjalori dialektor dhe atlas dialektologjik i të folmeve shqipe në tërësi. Është e kuptueshme që projekti i profesor Qosjes në këtë kohë nuk parashihet kërkime më të specializuara në fushë të gjuhësisë. Gjuhësia shqiptare në Kosovë ishte në fillimet e saj. Institucionet sapo ishin formuar. Kishte studiues mjaft të përkushtuar për kërkime në teren, por shumica prej tyre kishin përgatitje shkencore modeste. Pasuria më e madhe gjuhësore gjendej në teren, ku deri më tash kishim kryesisht hulumtues të rastit, ndërkohë që pasuria gjuhësore po shteronte me kalimin e kohës. Megjithatë i përkushtuar dhe i specializuar në fushë të letërsisë, në këtë rrjedhë nuk do të lë gjë mangut edhe vetë. Në veprimtarinë e tij letrare dhe sidomos shkencore e publicistike është e vështirë të gesh një vepër të vetme në të cilin nuk gjen një kapitull mbi gjuhën e kritikës, gjuhën e shkencës, të publicistikës a të strukturës së saj. Në periudhën e parë hyjnë kontributet e tij shumë të veçanta në fushë të standardizimit të shqipes letrare ndërmjet viteve 1968-1972, si dhe studimi i tij Përgjegjësia gjuhësore e shkrimtarit, i cili solli pikëpamje moderne në diskutimet e gjera që bëheshin në prag të Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe (Tiranë, 1972). Po në këtë kohë do vlerësuar angazhimi i tij konkret për organizimin e Kongresit dhe botimin e materialeve të tij në Prishtinë, ndërsa kulmi i këtyre angazhimeve paraqitet në fillim të viteve '80 kur ai solli analizat e para të lidhura me të nxëniet e shqipes standarde në fushë të kulturës dhe të shkencës së gjuhësisë e të terminologjisë së saj. Mjafton të shihen disa prej aspekteve a çështjeve që ka trajtuar në sprovën Tri mënyrat e shkrimit shqip (përgatitur për botim më 1979, por botuar e plotë dy dekada më vonë), për të kuptuar kritikën e tij rreth nocioneve, termave e togfjalëshave që përdorshin në shkencën e letërsisë, si: Gjuha zmadhuese, gjuha zmadhuese mbizotëruese stilistike, gjenezat teorike dhe kulturore e gjuhës zmadhuese, gjuha zmadhuese si gjuhë normative, zmadhimi si mjet gjuhësor, gjuha zmadhuese si gjuhë e fetish - fjalëve, gjuha zmadhuese si gjuhë maskuese, gjuha zmadhuese si gjuhë mitomaniqe, gjuha zmadhuese si gjuhë dogmatike etj. Në një nga studimet e tij gjithashtu me përmasa teorike dhe konceptuale Gjuha zmadhuese dhe terminologjia e saj, ai merret me çështjet e veçanta, si gjuha dhe

metagjuha, mangësia e termave, vërshimi i termave, fjalët e huaja, termat dhe zhargonet, duke e mbyllur trajtesën e tij me vërejtjen mbi kulturën e gjuhës, si kusht i funksionit kulturor të shkencës. Po i kësaj natyre është edhe studimi i kësaj kohe me titull Gjuha zmadhuese dhe gramatika, në të cilën veç tjerash trajtohen edhe çështjet: kur fjala s'është në vendin e vet, zmadhimi dhe përpikëria, kur gramatika s'e sundon fjalën, gramatika e cenuar, kur barbarizmat përdoren barbarisht etj. Prej kumtesave, analizave dhe studimeve shkencore, në të vërtetë prej nocioneve, termave dhe koncepteve që diskuton, si dhe prej kritikës ndaj dobësive që shfaqeshin në jetën letrare dhe sidomos shkencore dhjetë vjet pas mbajtjes së Kongresit të Drejtshkrimit të Gjuhës Shqipe, nuk është vështirë të shihet përkushtimi i tij intelektual dhe shkencor, ndaj gjuhës shqipe dhe kulturës gjuhësore. Prej termave dhe mendimeve që i botonte në shtypin ditor, shkencor dhe i diskutonte në konferencat shkencore nuk është vështirë të shihen angazhimet e tij për gjuhën letrare dhe përvetësimin e saj, për gjuhën letrare dhe vështirësitë që duhej tejkaluar për përvetësimin e saj, për gjuhën letrare dhe vetëdijen kulturore, për gjuhën letrare dhe gjuhësinë e zbatuar, për gjuhën letrare dhe institucionet arsimore dhe shkencore në Prishtinë, për çështjet që pritej të trajtoheshin në jetën shkencore dhe universitare të kohës, për gjuhën letrare dhe gjuhësinë e zbatuar etj. Periudhës së dyti i takojnë angazhimet e tij në mbrojtje të albanologjisë dhe të shqipes standarde nga sulmet e shtypit serb pas demonstratave të vitit 1981, si dhe angazhimet dhe mbrojtjes së shqipes standarde nga sulmet individuale a të organizuara të studiuesve e publicistëve shqiptarë pas vitit 1981. Fjala është për studimet, vlerësimet, polemikat dhe kumtesat përkujtimore në shenjë të institucioneve, personaliteteve dhe datave më të rëndësishme që e kanë identifikuar gjuhën shqipe si gjuhë historike dhe e kanë bërë gjuhë moderne, të botuara kryesisht në veprat Ligjërime paravajtëse (1996), Fjalor demokratik (1997), Ideologjia e shpërbërjes (2006), Rilindja e dytë (2007), Semantika e ndryshimeve historiko-letrare (2009) etj. Fjala është për artikujt, polemikat dhe çështjet që kanë të bëjnë me gjuhën shqipe dhe historinë e saj, por në mënyrë të veçantë për shqipen standarde dhe mbrojtjen e saj. Janë një varg sprovash kulturologjike për gjuhën e njësuar letrare, ndasitë dialektore dhe gjuhën e njësuar letrare, rënien e kulturës gjuhësore, gjuhën e politizuar, vërshimin e fjalëve të huaja, Mesharin e Gjon Buzukut (315-316) etj., botuar kryesisht në vëllimin Fjalor demokratik (1997). Të kësaj natyre janë edhe studimet në vëllimin Semantika e ndryshimeve

historiko - letrare, në të cilin veç tjerash janë botuar studimet me interes nga fusha e gjuhësisë: Vvetari i dytë (1845) i Naum Veqilharxhit - dokument i rëndësishëm i Rilindjes Kombëtare, Konsulta Gjuhësore e Prishtinës dhe vetëdija kombëtare, Roli i përkthimeve në zhvillimin historik të letërsisë shqipe, Kongresi i Manastirit - marrëveshje e madhe kombëtare etj. Po kaq me interes janë studimet, trajtesat dhe diskutimet e kumtesat e botuara në vëllimin Rilindja e dytë, në të cilën veç tjerash është botuar fjala e tij në simpoziumin shkencor kushtuar tridhjetë vjetorit të Kongresit të Drejtshkrimit në Tiranë, më 11.11.2002: brenda të cilit janë diskutuar probleme të natyrës teorike, sociolinguistike dhe kulturore, sikur janë ato për kontestimet e gjuhës standarde, për zhvillimin e gjuhës standarde, për gjuhën standarde dhe procesin e globalizimit, gjuhën standarde dhe planifikimin gjuhësor etj. Po këtu janë botuar portretet e dijetarëve të gjuhësisë së shekullit XX: Eqrem Çabej - dijetari i madh (99); portreti Idriz Ajeti - një jetë kushtuar gjuhës etj.

Përkushtimin e tij ndaj gjuhës më në fund e dëshmon veç tjerash edhe projektimi i saj në njërën prej monografive më të mira në letrat shqipe Porosia e madhe (Vepra e Naim Frashërit), si dhe në një prej projekteve më të rëndësishme të tij shkencore me karakter historiko-letrar Historia e letërsisë shqipe, Romantizmi I-III.

V. Ndhimesat në fushën e studimeve folklorike dhe etnografike

Në fushën e kërkimeve dhe të studimeve folklorike, - shkruante Profesor Qosja (...) duhet të vazhdohet mbledhja e thesarit gojor popullor në terren (...) e mandej, do të duhej të pasojnë studime me karakter më të përgjithshëm që, pos interesit shkencor, do të kenë edhe një përdorim të veçantë praktik nëpër shkollat të larta dhe fakultete, në të cilat studiohet edhe letërsia popullore; ndërsa në një syth më vete merrej edhe me fushën e kërkimeve dhe të studimeve etnografike (...), për të cilën mendonte se krahas mbledhjes deskriptive të lëndës dhe të të dhënave do të duhej të bëhen edhe studime të problemeve të veçanta drejt hartimit të veprave përmblendhëse sikundër janë fjalori mitologjik, e drejta zakonore, etika patriarkale, veshjet popullore, vallet popullore e të tjera. Ndryshe nga qëndrimi që ka mbajtur ndaj gjuhës dhe angazhimit të saj për përtirjen e saj si pjesë e neologjizmeve, nocioneve e termave të gjuhësisë, si dhe sjelljes së trajtave të reja fonologjike, gramatikore, sintaksore e leksikore, mbështetur në trashëgiminë e saj, ndaj folklorit mbajti qëndrim më të ngurtë. E kuptueshme. Letërsia shqipe, që nga fundi i periudhës së



romantizmit, ende nuk arrinte të çlirohej prej disa prej formave arkaike të saj, ndërsa realizmi socialist ia kishte mundësuar që ajo të folklorizohej edhe më tej. Ata që fillimisht nuk do t'i kuptojnë kritikën e tij ndaj shkrimtarëve të letërsisë kombëtare, sikur ishte Anton Zako Çajupi e ndonjë tjetër; ata që nuk donin të lexojnë a të marrin parasysh kritikën e tij ndaj disa shkrimtarëve të fundvitit 1960, sikur ishte shkrimtari Hasan Hasani, ata që nuk deshën t'i lexojnë a kuptojnë përsiatjet e tij ndaj folklorit dhe sidomos ndaj folklorizimit të studimeve historiko-letrare në fund të viteve '60 dhe në fillim të viteve '70, do të detyrohen të presin dhe lexojnë vlerësimin e tij Anarkia e kritereve, për veprën e Ismail Kadaresë Autobiografia e popullit në vargje, në të vërtetë, do të detyrohen të presin fundin e viteve '70 dhe të lexojnë sprovën Manifesti i modernitetit, si dhe të pajtohen me orientimet e tij metodologjike e teoriko-shkencore për Vetëdijen mbi modernitetin si vetëdije mbi tërësinë, në të cilën veç tjerash theksonte se: "Përmbajtja sentimentale, romantike, folklorizante, glorifikimi i veçorive më shumë a më pak të njohura të saj, pavarësisht prej mjetit poetik, nuk lejon modernitetin në krijimtarinë e sotme letrare. (...) Moderniteti, qoftë i letërsisë, qoftë i kritikës së saj, nuk mund të mbështetet në folklorizmin dhe në etnografizmin, në dekoracionin dhe në panagjizmin, në entuziazmin dhe në sentimentalizmin, sepse moderniteti është fryt i dyshimit mohues e jo i entuziazmit lavdërues.

Le t'i referohemi vetëm njërës prej sprovave të tij të zgjeruara mbi metodat e studimit të folklorit dhe të etnografisë, në të vërtetë të kulturës materiale e shpirtërore të

popullit shqiptar, në të cilin theksonte: "studimi i kulturës materiale dhe shpirtërore të popullit tonë edhe në kontekstin e kulturave materiale dhe shpirtërore të popujve të tjerë evropianë, si kusht i hetimit të modeleve të përbashkëta, në njërën anë dhe i modeleve autentike, origjinave kulturore, në anën tjetër. Popujt e Evropës, gjatë shekujsh, kanë pasur fatin e përbashkët historik dhe kulturor, prandaj edhe kanë krijuar përvoja të njëjta e të ngjashme kulturore, vlera materiale dhe shpirtërore, në të cilat, janë investuar dija, mjeshtëria, prirja, munda i shumë brezëve të tyre. Studimi krahasimtar i këtyre vlerave, por studimi i tyre i çliuar prej egoizmit dhe prej paragjykimëve kombëtarë, në të vërtetë pseudokombëtare doemos realizon një prej qëllimeve të rëndësishme shkencore: zgjeron horizontet e dijes në përgjithësi dhe, sidomos, afirmon besimin e arsyeshëm se kultura jonë kombëtare ishte dhe është shumëfish e lidhur me kulturën evropiane, se i takon bashkësisë shpirtërore evropiane. Do ta shikojmë dhe ta studiojmë, ashtu, kulturën dhe historinë tonë edhe në kontekstin e kulturës dhe të historisë evropiane, në radhë të parë me qëllim që ta shohim dhe ta kuptojmë më mirë kulturën dhe historinë tonë. Në të njëjtën kohë, me vënie e çështjeve të historisë dhe të kulturës së popullit tonë në perspektivën vrojtuese evropiane, jo vetëm se zgjerohet dhe thellohet, domethënë pasurohet, vizioni i historisë dhe kulturës sonë si segment integral i historisë dhe i kulturës evropiane, por edhe evitohet shikimi, kur e kur, izolacionist historik dhe kulturor, i aplikuar, ndonjëherë, me shumë pavetëdijshëm se sa vetëdijshëm në studimet albanologjike". (VIJON)

Sabile Basha, intelektuale dhe studiuese me vlera kombëtare



Ibrahim KABIL (Tiranë)

Më 23. 01. 2020 së bashku me tre bashkudhëtarë të tjerë, Gencin, Tinin dhe Rushin, u nisëm dhe bëmë një udhëtim të këndshëm, por edhe të lodhshëm, në Kosovë. U nisëm herët nga Tirana, në orën 6.0 dhe arritëm në orën 9:00. Udhëtimi qe komod dhe me agjendë të përcaktuar më parë. Shoferi ynë, Tini, u tregua i palodhur dhe na çoi për mrekulli në Prishtinë, pa asnjë avari. Meqenëse mëngjesin e kishim ngrënë në Morinë, u ulëm në një lokal në qendër për të pushuar dhe pirë diçka. Bëmë porosinë sipas dëshirës dhe natyrshëm filloi dhe biseda. Si ju duket Prishtina djema? i pyes unë. Në këtë kontakt të parë na duket shumë e mirë, por përgjigjen përfundimtare ta japim pasi ta shohim e vizitojmë mirë atë. Po, natyrisht kështu është. Kosova sapo ka dalë nga lufta e përgjakshme e vitit 1999 dhe në çdo pëllëmbë të saj ka gjurmë të përgjakshme. Numri i viktimave në luftë qe mbi 13 mijë. Serbia dhe Millosheviqi ushtruan një gjenocid të madh ndaj shqiptarëve të Kosovës. U desh UÇK-ja dhe ndërhyrja e NATO-s që Kosova të çlirohet dhe më pas ta krijojë shtetin e saj. U deshën 100 vjet që të vihej në vend kjo padrejtësi historike ndaj Kosovës. Më mirë vonë se kurrë, thotë populli... biseda rrodhi shtruar dhe qe e këndshme. Ora po kalon, them unë, sipas agjendës që kemi vendosur do të lëvizim? Po, mirë, po unë kam një shtesë të vogël. Është hera e 10 që vij në Kosovë nga 17 shkurti i 2008-s dhe nuk kam mundur të futem në librari, për mungesë kohe, ndaj kësaj radhe do të shohim për libra. A nuk ka libra në Tiranë, thotë Rush? Ka bile dhe shumë, por këtu jemi në Prishtinë dhe patriotizmi, atdhedashuria dhe urrejtja ndaj pushtuesit shekullor dhe barbar serb, marrin vlera të tjera. Dardania apo Kosova e

sotme është e shquar dhe shquhet për vlera të tilla. Dhe këtu si në Shqipëri, ka Institute, është UP-ja, Akademia e Shkencave, ka intelektualë dhe akademikë të shquar, bëhet punë shkencore e mirëfilltë dhe botimet shkencore e artistike janë të një niveli të lartë. Pse mërzhitesh, diçka të vogël, kërkova! Dhe kjo "diçkaja" e vogël që shtova u bë motiv e nxitje për të bërë këtë shkrim modest...

Koha po kalonte me shpejtësi dhe ne ikëm nga kafja, dolëm

për ta vizituar Prishtinën sipas planit të bërë më parë. Tre vizitorët që ishin me mua, si për herë të parë, shihnin me kureshtje dhe bënë edhe pyetje të ndryshme. Unë ndërkohë nuk e kisha mendjen fare aty dhe gati u "përhumba" në histori. Si në një film me metrazh të gjatë më "shfaqej" në kujtesë historia e vjetër, por dhe ajo e re, e Shqipërisë etnike, e më shumë ajo e Kosovës ku isha. Isha shumë i dyzuar dhe për shumë probleme të sotme të Kosovës kam qëndrim të kundërt me disa politikanë "vendimmarrës" në Prishtinë, por edhe gjetkë. E natyrshëm lindin disa pyetje: Si mund t'i falim tokë Malit të Zi? Përse nuk dënohet agresori, por viktimat? Përse Gjykata Speciale nuk merret me krimet e Serbisë dhe kriminelët e saj? Përse nuk përmenden më tri pikat e Grupit të Kontaktit në bisedimet me Serbinë? A mund të pranohet "bashkimi" i Kosovës me Shqipërinë pa Mitrovicën e tri komunat me shumicë serbe? Përse politikanët tanë bëhen trima mes vete, zihen, ofendohen, padisin njëri-tjetrin e me ndërkombëtarët sillen si servilë dhe janë inferiorë? Këto pyetje janë retorike dhe përgjigjen e

kanë brenda. Politikanët të tregohen të përgjegjshëm, të marrin si model rilindësit e shquar dhe figurat e shquara të kombit gjatë lëvizjes për liri e pavarësi dhe të mos ndjekin rrugën e Esatit e Morinës e sorollopëve të tyre....

Po, "Minishengeni Ballkanik" pa Kosovën a na duhet? Natyrisht, prerë, jo. Na duhet Minishengeni i BE-së dhe "minishengeni" Kosovë - Shqipëri. Serbia nuk e njeh Kosovën dhe ndoshta nuk ka për ta njohur kurrë. Punë e madhe! Asgjë s'na bën. Asnjë lëshim Serbisë pa e njohur Kosovën. Haradinaj u tregua burrështetas me taksën, nuk e pranoi dhe u tërhoq. Veprimi qe në shërbim të Kosovës. Shpresojmë ta bëjë edhe Albini.

Ndërsa ishim para Akademisë së Shkencave në Prishtinë në mendje më vjen ajo "marrëveshja historike" me Serbinë për linjën ajrore Prishtinë - Beograd. Më e çuditshme është se nuk u nënshkrua nga autoritetet kosovare. Shkak Rezoluta 1244. Kështu po kryeni shkatërrimin e shtetit të Kosovës. Po shkoni te Autonomia e Zgjeruar gradualisht. Mos e "çbëni" shtetin. E kemi pritur prej 100 vjetësh dhe

së fundmi e kemi. Turp për politikanët! Po akademikët ku janë? Shumica bëjnë indiferentin! Jo Sabilja dhe disa të tjerë.

Po kështu po ndodhë edhe me marrëveshjen për linjën hekurudhore. Dhe ajo qe në kohën e Jugosllavisë së Titos... politikanët edhe 6 muaj nga zgjedhjet zihen për postet! Akoma pa qeveri! Vështirë Kurti të bëjë marrëveshje me "ujkun" e vjetër në politikë, Mustafën... kjo qe ajo "përhumbla". Pas zhgënjimit, vjen shpresa. Unë ende kam shpresë! Por çfarë rëndësie ka shpresa ime?

Ndërkohë që ishim në librari, vizitës në Prishtinë po i vinte fundi. Destinacionet tona do të ishin Mitrovica dhe Prekazi. Gjatë kohës që po kërkonim për libra u drejtohem tre shokëve: "Më falni se, mbase, nuk kam qenë shumë i vëmendshëm ndaj jush". Si mësues historie, syrin dhe veshin e djathtë e kam pasur dhe e kam nga Kosova.

Në librari, me gjithë çmimet e kripura, blemë disa libra. Libri që blej u bë dhe nxitje për ta përshpejtuar këtë shkrim që po "flinte" nën "sirtar", qe ai i studiueses kosovare Sabile Keçmezi-Basha, me titull: "Kosova 1945-1990 (vështrim historiko-politik)". Që të jem i sinqertë me lexuesin, unë këtë autore e kam njohur nëpërmjet disa shkrimeve të saj të publikuara nga gazeta "Zemra Shqiptare". Nuk dija asgjë më shumë. Pasi mora librin dhe u njoha disi me të (kohë e shkurtër në dispozicion) më pëlqyen jashtë mase shkrimet e saj, tematika e përzgjedhur dhe trajtimi shkencor i tyre. Ky studim monografik i shkruar me shumë finesë e profesionalizëm nga prof. dr. Sabile Keçmezi-Basha është me shumë vlerë dhe i veçantë në llojin e vet. Fiksimi periodik dhe në mënyrë kronologjike i ngjarjeve në Kosovë, Shqipëri, Diasporë, por edhe në Serbi, është shërbimi më i mirë që mund t'i bëhet kombit tonë. Sabile Basha nga viti 1986 deri në vitin 2016 ka botuar mbi 16 botime shkencore, që të gjitha në shërbim të Kosovës e çështjes kombëtare. Po kështu ajo ka botuar edhe mbi 12 poezi dhe romanin "Nata pa kornizë". Ajo është shumë aktive dhe shpesh publikon në shtyp, por dhe boton vepra. Me një krijimtari të tillë ajo shërben si model, imponon respekt, përhap dije dhe kulturë, jep kontribut me punimet shkencore, tregon vlerat si intelektuale, por edhe ato patriotike e atdhetare. Ajo dhe të tjerë, si ajo, të ngjallin shpresë. Albini anon më shumë kah shpresa! Ajo vdes e fundit.


Tiranë, 26. 01. 2020



E rrallë

Një grua vdes në Australi në konkursin e ngrënies së ëmbëlsirave

Një grua humbi jetën në Australi derisa po mernte pjesë në një konkurs të ngrënies së ëmbëlsirave. Gruaja, 60 vjeçe, raportohet se ka pasur një komplikim gjatë aktivitetit që u mbajt të dielën në një hotel në Hervey Bay, Queensland, për ta shënuar Ditën e Australisë. Garuesit ishin filmuar më parë me ngrënie të



lamingtons, një tortë tradicionale si sfungjer e mbuluar me çokollatë dhe anë kokosi. Asaj iu dha ndihma e parë në vendngjarje dhe më pas u dërgua në spital, ku edhe vdiq më vonë.

FOTO E DITES



Ekipet emergjente shihen duke larguar një grua nga rrënojat e një ndërtese pas tërmetit që ndodhi në Elazig të Turqisë. /AFP/

E jashtëzakonshme

Së shpejti në treg akullorja me përbërje insektesh, mund ta blejnë vetëm pasanikët

Në Afrikën e Jugut do të dalë së shpejti në treg një akullore shumë e shtrenjtë e cila do të përdorë Ento Milk, një alternativë e qumështit e bërë nga përzierja e larvave të një insekti tropikal të njohur si mizat solare e zezë. Kombet e Bashkuara



parashikojnë që bota do të duhet ta dyfishojë prodhimin e ushqimit për ta ushqyer popullsinë globale deri në vitin 2050 dhe ka promovuar prej kohësh bujqësinë e insekteve si një burim të qëndrueshëm të proteinave për bagëtitë tradicionale.

BARSOLETA E DITËS



Gruaja: Burrë, a e shikojmë një film horror?
Burri: Në rregull, shpirt! Hajt lëshoje kasetën e dasmës tonë.



Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 18:00 Spies in Disguise 3D

I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

Rolet: Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

Regjia: Troy Quane, Nick Bruno



Në ora 18:00 Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min
Rolet: Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.
Regjia: Jake Kasdan



Çdo natë në ora 20:00 STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D

Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min
Rolet: Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj.
Regjia: J.J. Abrams




Çdo natë në ora 22:30 THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

Rolet: Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

Regjia: Takashi Shimizu



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.




DASHI
Në luftën midis detyrës dhe

kënaqësisë, ajo që fiton është detyra. Ju dëshironi të ndiheni i përmbushur dhe i vlerësuar.



DEMI
Sot do të jetë dita e zjarrtë e ideve falë

një qielli miqësor. Ajo sjell mundësi për propozime të reja, duke krijuar mundësi edhe për udhëtime.



BINJAKËT
Kur dilni nga zyra, harrojeni atë dhe lini

shqetësimet tuaja aty brenda. Projektet që keni, kërkojnë shumë ambicie dhe përkushtim.



GAFORRJA
Falë miqve të mirë që keni,

dashuria nuk mungon në asnjë çast. Prej tyre ju merrni një mbështetje shumë të madhe.



LUANI
Ditë pozitive për të gjithë ata

që kanë një aktivitet klerik. Aftësia juaj për të planifikuar dhe rregulluar gjithçka do të jetë e dukshme qartë.



VIJGJËRESHA
Do të tërhiqeni nga sharmi i

dikujt që mund të hyjë në jetën tuaj. Gjithçka do të jetë e shkëlqyeshme, si sentimentale ashtu edhe erotike.



PESHORJA
Sot do të zhgënjeheni nga një mik dhe

do të ndiheni e lënduar. Por, kjo nuk do ndikojë në relaksim tuaj.



AKREPI
Sot do të përballeni me shumë dashuri në

jetën tuaj. Do të jeni social dhe rreth vetes do të keni plot miq.



SHIGJETARI
Pavëmendjet dhe shpërqendrimet do të

jenë në rendin e ditës për shkak të Hënës në Virgjëreshë. Gjithmonë duhet të jesh me sytë e t'u hapur!



BRICJAPI
Do të jeni i lumtur me partnerin

edhe nëse ai është larg apo i angazhuar në fronte të tjera: midis WhatsApp-it, Telegram-it dhe Skype.



UJORI
Shijoni shoqërinë e të

dashurit tuaj dashurit tuaj. Keni kujdes, mund të ketë zona ku po flakni kohë dhe përpjekje për asgjë.



PESHQIT
Kritikat ndaj miqve, sado të

dashura, krijojnë ndërhyrje midis të dyve, mbase flasin për arsye të mira, por ajo fije xhelozie nuk përjashtohet.

Madonna kërkon ndjesë, anulon koncertin në Londër



Madonës i vjen tmerrësisht keq për faktin që u detyrua ta anulonte shfaqjen e parë në Londër të turneut të saj botëror "Madame X". Ylli i popit duhet t'i niste këtë të hënë 15 spektaklet e saj në London Palladium. Por, nga sa

shpjegonte në deklaratë, ishte "pllakosur nga disa dëmtime që prej fillimit të turneut dhe mjekët e kanë këshilluar të pushojë për disa ditë". Madonna ka sqaruar se personat që kishin blerë bileta për të hënë do të rimburohen.

Lana Del Rey e merr të dashurin në tapetin e kuq të Grammys



Lana Del Rey dhe i dashuri i saj e kanë zyrtarizuar lidhjen e tyre tashmë edhe në tapetin e kuq. Këngëtarja 34-vjeçare është parë e shoqëruar nga Sean "Sticks" Larkin në festën para mbajtjes së Grammy 2020. Ajo kishte veshur një fustan të

zi me detaje bezhë që kishte krahë të lëshuar dhe një çarje të thellë te këmbët, derisa i dashuri i saj kishte zgjedhur një kostum të zi. Kjo është edhe hera e parë që çifti është fotografuar së bashku në një ngjarje publike ku ka të pranishëm shumë yje.



Taylor Swift: Kam vuajtur urie me muaj për shkak se më thanë se dukeshin shtatzënë

"Miss Americana" është titulli i një dokumentari për jetën e Taylor Swiftit. Në mënyrë të veçantë ajo zbuloi në këtë dokumentar, ndër të tjera, se luftoi me problemet e ngrënies në të kaluarën e saj. "Nëse do të shihja një foto me stomakun

tim që shfaqej ose dikush duke më thënë se unë dukej sikur isha shtatzënë, ky do të ishte motivi im të ndihem e uritur dhe të ndaloja së ngrëni", ka thënë ajo. Taylor, gjithashtu, ka theksuar se një titull i gazetës e goditi veçanërisht shumë.

Billie Eilish shkruan historinë, fiton katër çmimet kryesore në Grammy

Ylli i muzikës pop, Billie Eilish, është fituesja e madhe e Grammys 2020. Ajo ka arritur të fitojë pesë çmime duke përfshirë çmimin për "Artisten e re më të mirë" dhe "Këngën e vitit". 18-vjeçarja e ka fituar edhe çmimin për "Albumin më të mirë të vitit" për albumin e saj debutues "When We All Fall Asleep, Where Do We Go", që është incizuar në shtëpinë ku ajo është rritur në LA. Ajo e ka zëvendësuar Taylor Swiftin duke u bërë kësh-



tu personi më i ri në moshë që e ka fituar këtë çmim. "Unë bëj shumë shaka lidhur me këto gjëra, por me të vërtetë dua të them se jam shumë mirënjohëse", ka thënë këngëtarja.

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

Mes tensioneve zgjedhet Komiteti Ekzekutiv i FFK-së

"Opozita" e FFK-së ka qenë e pafuqishme me kundërshtime ndaj drejtuesve të Federatës së Futbollit, pasi të hënën është zgjedhur Komiteti Ekzekutiv për mandatin katërvjeçar. Ndërsa përfaqësuesi i FIFA-s, Olver Jung, e ka vlerësuar legjitim këtë Kuvend Zgjedhor. "Po e shohim se kemi demokraci në këtë proces. Kemi shumicën e anëtarëve që votuan për Komitetin Ekzekutiv. Ata që dolën mund të bëjnë pauzë, por me rëndësi ne e kemi shumicën", ka thënë Jung



EPOKA E RE
Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 27 JANAR - Anëtarët e Komitetit Ekzekutiv të Federatës së Futbollit të Kosovës janë zgjedhur për mandat katërvjeçar me 37 vota për, kurse të pranishëm ishin 55 delegatë. Votimi është përsëritur dy herë pasi disa prej përfaqësuesve të klubeve nuk e pranuan rezultatin e votimit të parë. Tensionet në këtë kuvend nuk munguan, "shpërthimi" i disa përfaqësuesve të klubeve erdhi kur kryetari Agim Ademi kërkoi mocion votëbesimi për ta unifikuar mandatin e tij me mandatin e Komitetit Ekzekutiv, por kjo nuk ndodhi. Siç dihet, Ademi ka mandat deri në vitin 2022.

Trajneri i Llapit, Tahir Batatina, që ishte më i zëshmi në këtë

Kuvend Zgjedhor, ka thënë se kryetari Ademi po e shkel statutin e FFK-së. "Në futbollin e Kosovës kanë ardhur njerëz që ia duan të mirën futbollit. Më vjen keq për atë reagim, por statutin e shkeli kryetari Agim Ademi. Mandati i tij ka skaduar më 15 janar, pasi ka qenë dyvjeçar", ka thënë Batatina, i cili më pas ka vazhduar akuzat në drejtim të Ademit edhe në profilin e vet në "Facebook". "Agim Ademi me mercenarë po e mban të uzurpuar Federatën e Futbollit të Kosovës, pa përkrahje të klubeve", ka shkruar Batatina. I ashpër në reagim ka qenë edhe kryetari i Trepçës '89, Abedin Zeka, i cili ka kërkuar që të respektohen ata që po financojnë në futboll. "Këtu janë anëtarët e Komitetit Ekzekutiv që janë votu-

ar nga shkollat e futbollit. Nuk është e drejtë të flitet njëjtë sikur ata që marrin dhe sikur ata që japin. Jemi grumbulluar që futbollit të shkojë përpara. Edhe ditë më parë kemi shprehur pakënaqësitë tona së bashku me disa kryetarë të tjerë", ka thënë Zeka. "Duam që të përfundojë kampionati sa më mirë, të dihet fati i mjeteve për klubet e Superligës. Kërkoj nga ti kryetar që të jemi pjesë e atyre që japin në FFK. Për hir të futbollit dhe korrektësisë, të shkojë puna siç është më së miri. Nuk më pengon Agimi si kryetar, por dua që t'i heqim pakënaqësitë tona dhe nëse ia del, do të jesh hero i futbollit", ka shtuar Zeka.

Kuvendin Zgjedhor e ka vlerësuar legjitim zyrtari i FIFA-së, Olver Jung. "Gianni Infantino u ka dëshiruar urimet më të mira për këtë kongres. FIFA dhe FFK-ja kanë lidhje të fuqishme. FIFA përkrah zhvillimin e projekteve të federatave, gjithashtu edhe FFK do të përkrahët me projekte të tjera. Uniteti i FFK-së është shumë i rëndësishëm. Dua ta falënderoj presidentin Ademi për bashkëpunimin e hapur deri tash. Kjo na ka lehtësuar punën deri këtu. Deri më tani kemi bërë shumë reforma. Po e shohim se kemi demokraci në këtë proces. Kemi shumicën e anëtarëve që votuan për komitetin ekzekutiv.

Ata që dolën mund të bëjnë pauzë, por me rëndësi ne kemi shumicën", ka thënë Jung. Përveç Jungut, i pranishëm në këtë Kuvend Zgjedhor ishte edhe përfaqësuesi i UEFA-s, Denis Bastari. Kuvendin e FFK-së e ka përshëndetur edhe sekretari i Federatës Shqiptare të Futbollit, Ilir Shulku, kryetari i Komitetit Olimpik të Kosovës, Besim Hasani dhe drejtori i Departamentit të Sportit, Ibër Alaj. Po në këtë kuvend, me propozim të kryetarit të Prishtinës, Remzi Ejupi, e me pajtim të klubeve, mëditjet janë ndarë për portierin e Trepçës '89, Arben Beqiri, i cili është diagnostifikuar me tumor në lukth.

Kristina Ukaj do ta përfaqësojë Kosovën



PRISHTINË, 27 JANAR - Federata e Hendbollit të Kosovës po e vazhdon punën për t'i forcuar ekipet përfaqësuese. Të hënën pjesë e Përfaqësueses së Kosovës është bërë portierja cilësore Kristina Ukaj, që bën karrierë në kampionatin e Zvicrës.

Klubi i saj, SPONO Eagles, të hënën zyrtarisht ka njoftuar FHK-në se Ukaj me shumë kënaqësi ka pranuar që të jetë në dispozicion të Kosovës. Ukaj para se ta marrë vendimin është konsultuar me klubin, me drejtorin

sportiv dhe me prindërit. Ajo është e nderuar dhe e vetëdijshme për rëndësinë që ka paraqitja në Përfaqësuesen e Kosovës. Ukaj është nga Kosova, ndërsa është e rritur në Zvicër. Këtë edicion po paraqitet me shumë suksese për SPONO Eagles në kampionatin e Zvicrës. Në ndeshjen e fundit ndaj Rotweiss Thunit, portierja e re shënoi dy gola, ndërsa ndali 11 nga 25 gjuajtjet në drejtim të portës së saj. Pra, ndali 44 % të gjuajtjeve. Ishte prej më meri-

toreve për fitoren e SPONO Eagles (24:23). Në ndeshjen e parafundit kampionale kishte pritur 59 % të gjuajtjeve. Në shumicën e ndeshjeve kishte përqindje të lartë të goditjeve të pritura. Kristina Ukaj i bënë 21 vjet në mars, ndërsa është e gjatë 176 centimetra. Ka përvojë edhe në Kupa Evropiane. Kosova dy ndeshjet e ardhshme i luan ndaj Bjellorusisë, më 25 mars në Prishtinë e më 29 mars në Minsk. Ndeshjet i takojnë fazës së dytë të eliminatorëve për "Euro 2020".

Gattuso jep sinjalin, Hysaj nuk lëviz nga Napoli

NAPOLI, 27 JANAR - Mbrojtësi i Kombëtares së Shqipërisë, Elseid Hysaj, e ka të ardhmen në skuadrën e Napolit, pasi trajneri Gennaro Gattuso dëshiron që shqiptari ta rinovojë kontratën. Lajmin e ka konfirmuar agjenti i

Hysajt, Maroi Giuffredi. "Me Gattuson, Hysaj ka fituar besim dhe po shpreh veten e tij në nivelin e duhur. Ai tregoi se çfarë ishte në gjendje të bënte kundër mentorit të tij Maurizio Sarri. Gattuso ka dhënë pëlqimin për

rinovimin e kontratës dhe për këtë çështje po diskutojmë aktualisht. Pritet që çdo gjë të zgjidhet në fund të shkurtit. Nëse ia dalim, rinovimi do të vijë, nëse jo, Hysaj do të shitet në qershor", ka thënë Giuffredi.



Barrichello: Hamiltoni është më i talentuar se Schumacheri dhe Senna

LONDËR, 27 JANAR - Ish-piloti brazilian, Rubens Barrichello, është një nga ata të paktët pilotë që ka pasur mundësi të pilotojë në Formula 1 bashkë me mjaft ikona të këtij sporti, si Ayrton Senna, Michael Schumacher dhe, së fundi, Lewis Hamilton

(ka garuar në vitet 1993-2011). Me 322 gara të zhvilluara në karrierën e tij, Barrichello bën një krahasim mes këtyre ikonave të Formula 1. "Për mendimin tim Hamiltoni është piloti më i talentuar në Formula 1. Më i fortë se Michael Schumacheri dhe

Ayrton Senna. Kur dueloja me të në pistë e vetmja gjë që i ka munduar ishte pjekuria, që e ka fituar me kalimin e viteve. Përmirësohet nga viti në vit dhe rezultatet duken në pistë", ka thënë Barrichello, ish-shok skuadre me Schumacherin. "Ajo

që e bën më të veçantë është se Lewis është gjakftohtë në pistë, sidomos në çastet vendimtare. Është mjaft i saktë në veprimet që bën dhe komunikon me skuadrën për gjëra konkrete, për ato që ka nevojë", ka deklaruar Barrichello.



Bota shpreh dhimbje për yllin e NBA-s, Kobe Bryant

LOS ANGELES, 27 JANAR - 26 janari ishte një ditë e errët jo vetëm për basketbollin, por për të gjithë botën sportive. Me këtë datë humbi jetën në një aksident fatal legjenda e NBA-s, Kobe Bryant. 41-vjeçari po udhëtonte me helikopterin privat, në bordin e së cilës ishte edhe vajza e tij 13-vjeçare Gianna si dhe 7 persona të tjerë, duke përfshirë këtu edhe pilotin. Mendohet se shkak i aksidentit u bë mjegulla që shkaktoi problem me vizibilitetin e pilotit me helikopterin që u përplas me një kodër rreth 420 m të lartë teksa po fluturonte me shpejtësi 296 km/h. Kjo tragjedi e Kobe Bryantit preku të gjithë botën. Emra të mëdhenj të sportit e jo vetëm, si presidenti Donald Trump, komisionari i NBA-së, Adam Silver, basketbollistë si Shaq O'Neal apo edhe futbollistë e klube futbollit, mes të cilëve edhe Ronaldo e Messi, shprehën dhimbjen e tyre për humbjen e jetës së Kobe Bryantit, mesazhe të cilave iu bashkuan edhe klube futbollit, lojtarë e sportistë shqiptarë.

Dy prej yjeve të NBA-së, LeBron James dhe Dwayne Wade, shprehën dhimbjen e tyre për këtë humbje të madhe, madje Wade nuk arriti t'i përmbajë as lotët. "E kam ndjekur Koben që në vitet e shkollës së mesme. Është një person nga i cili u frymëzova, mora motivim. Më ndihmoi edhe para se të



më njihte, për shkak të asaj që ai ishte në gjendje që të bënte", ka thënë LeBron. "Sot është një nga ditët më të trishtuara të jetës sime. Është si një ëndërr e keqe nga e cila dëshiron që të zgjohesh, është një makth. E di që të gjithë ndiheni si unë për një lider e kampion të madh e një person fantastik. Do të më marrë malli për të e miqësinë e tij", është shprehur Wade. Kobe Bryant ishte i pranishëm edhe në ceremoninë e ndarjes së çmimeve Grammy, ku këngëtarja e njohur Alicia Keys në momentin e hapjes së mbrëmjes i dedikoi një homazh këtij basketbollist të madh. Ndërsa në Los Anxhelos tifozë të shumtë iu drejtuan

Staples Centerit për ta nderuar kujtimin e Kobe Bryantit, një basketbollist spektakolar që ka ditur t'i arëtojë me lojën e tij. Ndërkaq, NBA vendosi të mos pezullojë ndeshjet e radhës së kampionatit dhe skuadrat gjetën mënyrat e tyre për të nderuar këtë legjendë të basketbollit. Në New York, Madison Square Garden u ndriçua nga ngjyrat verdhë e vjollcë të skuadrës së LA Lakersit. Ndërsa në San Antonio dhe Memphis, në sfidat e luajtura në këto dy qytete basketbollistët vendosën ta mbajnë lojën për 8 dhe 24 sekonda në startin e saj, ndërkohë që të pranishmit u dëgjuan ta thërrisnin emrin e Kobe Bryantit.

Denveri shfrytëzoi mungesën e Hardenit dhe mposhti Houstonin

DENVER, 27 JANAR - Është shumë e vështirë të flasësh për ndeshjet e NBA-së pas asaj që i ndodhi legjendës së basketbollit, Kobe Bryant. 26 janari është dita kur bota e sportit u trondit nga ndarja e parakohshme nga jeta e "Black Mambas". Liga Amerikane, pavarësisht kërkesës së disa skuadrave për të kundërtën, vendosi që ndeshjet të zhvilloheshin sipas programit, me moton "The Show must go on". Skuadrat e para që zbritën në parket ishin Denver Nugget dhe Houston Rockets, me skuadrën nga Colorado që fitoi 117-110, e udhëhequr nga serbi Nikola Jokiq, autor i një "triple double": 24 pikëve, 12 "reboundeve" dhe 11 asistimeve. Ndihmë të madhe në këtë sukses të Nuggetsit dha me 25 pikë edhe Jerami Grant. Për Rockets, që nuk kishte në dispozicion James Hardenin, spikati me 32 pikë Russell Westbrook, por pa mundur të shmange humbjen. Prekëse ajo që ndodhi mes San Antonio Spursit dhe Toronto Raptorsit, me të dyja skuadrat që lanë të kalonin 24 sekonda në kontrollin e parë të topit, si homazh për Kobe Bryantin, që para se të tërhiqej nga basketbolli mbajti veshur fanellën me



numër 24. Sa i përket rezultatit, fituesit në fuqi të NBA-së iu imponuan 106-110, me Pascal Siakam, autor të 35 pikëve. New

Orleans Pelicansi mposhti në sfidën e shtëpisë Boston Celtics 123-108. Shënuesi më i mirë rezultoi Jrue Holiday me 25 pikë, ndërsa Zion Williamson dha një tjetër performancë të mirë duke regjistruar "double double": 21 pikë e 11 "rebounde". Për Celticsin spikati me 35 pikë Kemba Walker. Kawhi Leonard, autor i "double double" (31 pikë dhe 14 "rebounde", frymëzoi Los Angeles Clipper për të fituar 97-112 në parketin e Orlando Magicut. Ndeshje me pikaverash të lartë në "State Farm Arena", ku Atlanta Hawksi mposhti Washington Wizardsin me rezultatin 152-133. Trae Young fitoi sfidën brenda sfidës me Bradley Bealin, duke shënuar plot 45 pikë dhe dhënë 14 asistime (Beal realizoi 40 pikë). Tjetër paraqitje "monstruoze" e Damien Lillardit, që udhëhoqi me 50 pikë e 13 asistime drejt suksesit 139-129 Portland Trail Blazersin ndaj Indiana Pacersit, ndërsa New York Knicksi fitoi derbin e New Yorkut ndaj Brooklyn Netsit me rezultatin e ngushtë 110-97. Vendimtar në këtë sukses të Nicks Julius Randle, që e mbylli takimin me "double double": 22 pikë e 15 "rebounde".

REZULTATET

Denver Nuggets - Houston Rockets	117-110
San Antonio Spurs - Toronto Raptors	106-110
Atlanta Hawks - Washington Wizards	152-133
Memphis Grizzlies - Phoenix Suns	114-109
New Orleans Pelicans - Boston Celtics	123-108
New York Knicks - Brooklyn Nets	110-97
Orlando Magic - Los Angeles Clippers	97-112
Portland Trail Blazers - Indiana Pacers	139-129

SHKURT

Berisha në formacionin e javës në Australi

Besart Berisha po kalon nëpër një formë fantastike që nga rikthimi i tij në Australi. Sulmuesi shqiptar u transferua te Western Unitedi, duke i ndihmuar të rikthehet paksa në formë. Berisha ka zhvilluar tashmë 200 paraqitje në ligën australiane, derisa ka shënuar dy gola në aventurën e tij të re në xhiron e kaluar. Ish-reprezentuesi i Kosovës deri më tani ka arritur të shënojë 11 gola në 14 paraqitje, por që në javën e kaluar tregoi një formë të lartë. Edhe pse skuadra e tij pësoi humbje 4-3, Berisha arriti të futej në formacionin e javës së A-League në Australi.

Aston Villa planifikon rikthimin e Bentekes

Drejtuesit e Aston Villas dëshirojnë ta përmirësojnë sa më shumë repartin e avancuar dhe për këtë mendojnë të rikthejnë në skuadër Christian Benteken, i cili që nga viti 2016 është pjesë e skuadrës së Crystal Palace, ku këtë sezon nuk po arrin të shkëlqejë, pasi në 15 aktivizime nuk ka shënuar asnjë gol. Pas nënshkrimit me Cenk Tosun, drejtuesit e Palace janë të gatshëm të heqin dorë nga 29-vjeçari, i cili me shumë mundësi do të rikthehet në Birmingham. Për kartonin e futbollistit belg drejtuesit e Crystal Palace kërkojnë 10 milionë euro.

Sarri 'tërbon' tifozët e Juves

Juventusit pësoi humbjen e dytë në kampionat pasi u mposht nga Napoli në "San Paolo" me rezultatin 2-1. Në konferencën e zakonshme për shtyp, trajneri i bardhezinjve, Marzio Sarri, ka befasuar me deklaratën e tij. "Jam shumë i lidhur me këtë qytet dhe do të jem gjithmonë, por në fund e merituar, pasi ne ishim shumë pasivë. Madje nëse do të më kishin thënë që të zgjidhja se përballë cilës skuadër do të kisha pranuar që të humbja, ai do të ishte vetëm Napoli", nënvizon trajneri i Juventusit.

Nadali kualifikohet në çerekfinale të Australian Openit

Është mbyllur raundi i katërt i grand slam të Australian Open në tenis, duke përcaktuar edhe tetë tenistët më të mirë në secilin kategori. Te meshkujt, numri 1 në botë, spanjoli Rafael Nadal, mundi 3-1 australianin Nick Kyrgios (6-2, 2-6, 7-6, 7-6). Ndeshje me rivalitet dhe emocione, ku të dy tenistët dueluan fort, por në fund triumfoi spanjoli, që arriti ta bëjë diferencën në momentet vendimtare.

Në ndeshjet e tjera për meshkuj spikat kualifikimi i numrit 4 në botë, austriakut Dominic Thiem. Ai mundi 3-0 (6-2, 6-4, 6-4) francezin Gael Monls. Një biletë për në çerekfinale sigurojnë edhe zvicerani Stanislas Wawrinka (3-2 ndaj Daniil Medvedev) si dhe gjermani Alexander Zverev (3-0 ndaj Andry Rublev).

Te femrat, surprizë eliminimi i tenistes gjermane Angelique Kerber, fituese në Melburn në vitin 2016 dhe ish-numri 1 në botë. Ajo u mund 2-1 nga tenistja ruse Anastasia Pavlyuchenkova (6-7, 7-6, 6-2). Në çerekfinale kualifikohen edhe tenistja rumune Simona Halep (2-0 ndaj Elise Mertens), ajo spanjolle Garbine Muguruza (2-0 ndaj Kiki



Komuna Shtërpçë
Drejtoria Komunale për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport

Bazuar në Ligjin e Punës nr.03/L-212 neni 8; Udhëzimi Administrativ (MPMS) 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, Drejtoria Komunale për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport shpall:

KONKURS

SHFMU. "Osman Mani" Firajë

Titulli i vendit të punës: Pastrues
Orët e punës në javë: 40
Koeficient: 4/1
Numri i referencës:08-111/01-931/20

SHML. "Kongresi i Manastirit" Firajë

Titulli i vendit të punës: Pastrues
Orët e punës në javë: 40
Koeficient: 4/1
Numri i referencës: 08-111/01-931/20

Përshkrimi i vendit të punës:

I punësuar është i obliguar të kryej të gjitha punët, në këtë rast, të cilat kanë të bëjnë me objektin shkollor, pastrimin dhe mirëmbajtjen e të gjitha hapësirave brenda objektit shkollor:

- higjenën e mësonjëtove, sallave të ndryshme, korridoreve, tualetet, ambientin e jashtëm në pronësi të shkollës, detyrat tjera të përcaktuara nga drejtori i shkollës, ta respektoj kodin e mirësjelljes etj..

Kushtet e konkursit:

Për këto dy pozita të punës e obligueshme është diploma e shkollës fillore.

Dokumentet e nevojshme për konkurim:

- Diploma
- Certifikata e lindjes
- Letërnjoftimi
- Vërtetim nga gjykata

Kohëzgjatja e kontratës së punës fillon prej datës së fillimit të punës deri më 31.08.2020

Fletëaplikacionet mirren në DKA ose në shkollë dhe dorëzohen (me dëshmi të verifikuar të kualifikimeve) në objektin e Komunës së Shtërpçës, zyra nr. 28

Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen, ndërsa aplikacionet e mangëta refuzohen.

Konkursi është i hapur 15 ditë nga dita e publikimit zyrtar (tabela e shpalljeve, ëbfaqen e komunës, gazetë ditore), duke filluar nga data 28.01.2020 deri më 12.02.2020

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

C.nr.121/2019

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Naim Mehulli në çështjen juridike të paditëses: Edenisa Nishlija nga Mitrovica Rr. "Adem Voca" e cila është nën kujdestarinë e gjyshes së saj Mirsada Nishlija nga Mitrovica të cilat i përfaqëson Nadire Koshi zyrtare e lartë për pa shtetësi pranë Organizatës për të Drejtat Civile në Kosovë kundër të paditurve: Senad Nishlija nga Mitrovica Rr. "Adem Voca" dhe Suada Beraj nga Mitrovica, tani me adresë dhe vendbanim të panjohur, gjykata me datën: 23.01.2020 konform neni 79.3 të LPK-së mori këtë:

A K T V E N D I M

I. Caktohet përfaqësuesi i përkohshëm Av. **Jetullah Berisha** nga Mitrovica si përfaqësues i përkohshëm i të paditurës së dytë: Suada Beraj nga Mitrovica, tani me adresë dhe vendbanim të panjohur.

II. Përfaqësuesi i përkohshëm në kuptim të neni 82 të LPK-se, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjorë, të cilat i ushtron deri sa të paraqiten në gjykatë e paditura apo përfaqësuesi me prokurë, respektivisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftoj gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

III. Ky aktvendim në afat prej shtatë ditësh të shpallet në tabelën e shpalljes së gjykatës, të botohet në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, si dhe të botohet në njëerë nga gazetatat ditore të Kosovës apo sipas nevojës të shpallet në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme.

Arsyetim

Paditësja Edenisa Nishlija nga Mitrovica e cila është nën kujdestarinë e gjyshes së saj Mirsada Nishlija nga Mitrovica, të cilat i përfaqëson Nadire Koshi zyrtare e lartë për pa shtetësi pranë Organizatës për të Drejtat Civile në Kosovë me datë 05.02.2019 ka parashtruar padi kundër të paditurve: Senad Nishlija nga Mitrovica Rr. "Adem Voca" dhe Suada Beraj nga Mitrovica, tani me adresë dhe vendbanim të panjohur, me objekt të padisë vërtetim atësie.

Gjykata me datën 17.12.2019 ka caktuar seancë përgatitore në të cilën seancë ka prezantuar kujdestarja e paditëses Mirsada Nishlija, përfaqësuesja e tyre Nadire Koshi dhe i padituri i parë Senad Nishlija, i cili ka pranuar e paditura e dyte Suada Beraj pasi që nga fletkthesa është konstatuar se adresa e tyre është e panjohur. E autorizuar e paditëses gjate seancës i ka propozuar gjykatës që procedurën e paditurës së dyte Suada Beraj nuk i dihet vendbanimi, të mos të përkohshëm i përkohshëm.

për të paditurën e dyte Suada Beraj nga Mitrovica, por nga njëjtimi i Policisë së Kosovës-Stationi Policor Jug-Mitrovicë me datën 03.01.2020 ka rezultuar se për të njëjtën kanë dal për verifikimin e adresës dhe pas disa informatave të marra nga fqinjët në mesin e tyre edhe me kryesuesin e lagjes RAE z.Qazim Gushani është konstatuar se e njëjta nuk jeton më në Kosovë, por ka shkuar të jetoj me prindërit e saj në Krallë të Serbisë.

Pas shqyrtimit të propozimit të të autorizuarës së palës paditëse, gjykata vlerësoi se ky propozim për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm të paditurës së cekur më lartë është i bazuar pasi që janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore të parapara me neni 79.3 pika a) të LPK-se, ndërsa për përfaqësues të përkohshëm bazuar në propozimin e Odës së Avokatëve të Kosovës të dt.23.01.2020 ka caktuar përfaqësuesin e përkohshëm Av. Jetullah Berisha nga Mitrovica.

Përfaqësuesi i përkohshëm në kuptim të neni 82 të LPK-se, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjorë, të cilat i ushtron deri sa të paraqiten në gjykatë e paditura apo përfaqësuesi me prokurë, respektivisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftoj gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

Nga se u tha më lartë konform neni 79.3/1, neni 82.1.2 si dhe neni 387.1 të LPK-së vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr.121/2019 me date 23.01.2020

GJYQTARI,
Naim Mehulli

UDHËZIM JURIDIK – Kundër këtij aktvendimi nuk është lejuar ankesa.





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Fondi i Sigurimit Shëndetësor/Fond za Zdravstveno Osiguranje/Health Insurance Fund

Bazuar në nenin 8 dhe neni 10 paragrafi 2 nenparagrafi 2.3 të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës si dhe në mbështetje të neni 4 dhe neni 5 të Udhëzimit Administrativ(MPMS) Nr. 07/2017 Për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, si dhe në bazë të Statutit të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore, Fondi i Sigurimit Shëndetësor shpallë këtë Konkurs Publik.

Data e publikimit: 28/01/2020
Nr. Referencës: FSSH- 01/01/2020

SHPALLJA E KONKURSIT

Institucioni: Fondi i Sigurimit Shëndetësor
Titulli i vendit të punës: Përkthyes/e Gjermanisht-Shqip dhe anasjelltas
Paga Bruto: 700 €
Nëpunësi mbikëqyrë: Udhëheqësi i Departamentit për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme
Orari i punës: 20 orë në javë
Lloji i kontratës: Për Punë dhe Detyra Specifikë

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Përkthim profesional i materialeve nga gjuha Gjermane në gjuhën Shqipe dhe anasjelltas;
- Përkthim simultant nga gjuha Gjermane në Shqip dhe anasjelltas, në takime të niveleve të ndryshme të FSSH-se;
- Shërbimet e përkthimit edhe gjatë ngjarjeve të ndryshme të organizuara nga FSSH;
- Mban evidencën e të gjitha kopjeve të përkthimeve të dokumenteve dhe regjistrin e materialeve të përkthitura;
- Këshillon në kohë për përfundimin e përafërt të kërkesave për përkthim të dokumenteve nëse i kërkohet ta bëjë këtë;
- Kujdes i lartë dhe maturi të madhe për të ruajtur konfidencialitetin e të gjitha materialeve që lidhen me punën;
- Përgatitja e raporteve periodike të punës;
- Kryen punë tjera me kërkesë të Udhëheqësit të Departamentit;

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim: Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin adekuat dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave.

Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar që i plotëson kriteret e konkursit.

Shkollimi i kërkuar: Diplomë universitare të Gjuhës Gjermane.

Aftësitë/përvoja dhe atributet e tjera që kërkohen;

- Duhet të ketë njohuri si përdoren pajisjet e përkthimit, të ketë njohuri mbi terminologjinë juridike si dhe të jetë i qartë gjatë komunikimit me të tjerët;
- Duhet të ketë aftësinë për të përkthyer apo për të komunikuar në praninë e një numri të madh të njerëzve / para publikut;
- Duhet të ketë shkathhtësi dhe aftësi shumë të mira të komunikimit, si me gojë ashtu edhe me shkrim nga gjuha shqipe në atë gjermane dhe anasjelltas;
- Duhet të tregojë gatishmëri për të punuar me sa më pak mbikëqyrje;
- Duhet të ketë aftësinë për caktimin e prioriteteve të punës si dhe të ketë shkathhtësi shumë të mira për të menaxhuar me kohën në dispozicion;
- Duhet të ketë shkathhtësi dhe aftësi shumë të mira të komunikimit si me gojë ashtu edhe me shkrim si dhe aftësi të fuqishme ndër-personale;
- Duhet të ketë aftësi për menaxhimin efikas të kohës në dispozicion si dhe të jetë i aftë për përbushjen e të gjitha afateve të vëna kohore për kryerjen e detyrave të punës.
- Njohja e gjuhës angleze, përparësi;

Kandidatët duhet t'i dorëzojnë këto dokumente:

- Aplikacionin së bashku me CV
- Dëshmi për shkollimin dhe përvojën e punës
- Kopja e letërnjoftimit ose pasaportës

Data e publikimit dhe e mbylljes së konkursit: 28/01/2020 deri më 11/02/2020

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren në Divizionin e Burimeve Njerëzore në Fondin e Sigurimit Shëndetësorë dhe dorëzohen në zyrën e Divizionit të Burimeve Njerëzore, Zyra nr.13, adresa: Prishtinë, Lakërishtë, Rruga Tirana. Objekti " Beni Dona". Në aplikacion duhet të çekët qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës. Informacionet shtesë mund të mirë në këtë nr tel: 038 20080705

Aplikacionet e dërguara pas datës së mbylljes së konkursit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

Petrit Bruqi
Udhëheqës i Divizionit të Burimeve Njerëzore



Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government

Fondi i Sigurimit Shëndetësor/Fond za Zdravstveno Osiguranje/Health Insurance Fund

Na osnovu člana 8 i član 10 stav 2 podstav 2.2 Zakona br. 03/L-212 o radu, kao i u skladu sa članom 4 i članom 5 Administrativnog uputstva (MRSZ) br. 07/2017 o regulisanju procedura konkurisanja u javnom sektoru, kao i na osnovu Statuta Fonda za zdravstveno osiguranje, Fond za zdravstveno osiguranje objavljuje javni konkurs.

Datum objavljivanja: 28/01/2020
Br. reference:Fzo- 01/01/2020

OBJAVA KONKURSA

Institucija: Fond za zdravstveno osiguranje
Naziv radnog mesta: Njemački- Albanski prevoditelj i obrnuto
Plata Bruto: 700€
Nadzorni službenik: Rukovodilac Departmana za Finansije i Opstih Usluga
Radno vreme: 20 časova u nedelji
Vrsta ugovora: O radu i specifičnim zadacima

Obaveze i odgovornosti:

- Stručno prevođenje materijala sa nemačkog jezika na albanski jezik i obrnuto;
- Simultani prevod sa nemačkog jezika na albanski i obrnuto, na sastancima FZO-a različitih nivoa;
- Pružanje prevodilačkih usluga tokom različitih događaja koje organizuje FZO;
- Vodenje evidencije o svim kopijama prevedenih dokumenata i registra prevedenog materijala;
- Pružanje pravovremenih saveta o približnom ispunjenju zahteva za prevod dokumenata, ukoliko je potrebno;
- Visoka opreznost i pažnja za poverljivo očuvanje svih materijala koji se tiču posla;
- Priprema periodičnih izveštaja o radu;
- Obavljanje drugih poslova na zahtev šefa odeljenja;

Uslovi za učesće u regrutovanju: Pravo aplikacije imaju svi punoletni državljani Republike Kosova koji imaju punu poslovnu sposobnost, koju su završili adekvatno obrazovanje i koji imaju profesionalnu sposobnost u obavljanju poslova

Procedure konkurisanja: konkurs je otvoren za sve zainteresovane kandidate koji ispunjavaju kriterije

Zahtevano školovanje: Universitetska Diploma iz nemackog Jezika.

Potrebne veštine-iskustvo i druge osobine:

- Potrebno znanje o korišćenju prevodilačke opreme, poznavanje pravne terminologije i jasna komunikacija sa drugima;
- Posedovanje veštine prevođenja i komunikacije u prisustvu velikog broja ljudi/ pred javnošću;
- Posedovanje veoma dobre veštine komunikacije, usmeno i pismeno sa albanskog na nemački jezik i obrnuto;
- Spremnost da radi sa što manje nadzora;
- Spremnost za određivanje prioriteta na poslu i veoma dobre veštine za upravljanje raspoloživim vremenom;
- Veoma dobre veštine verbalne i pismene komunikacije i snažne međuljudske veštine;
- Sposobnost efikasnog upravljanja raspoloživim vremenom i sposobnost za ispunjenje svih zadatih rokova za izvršavanje zadataka.
- Poznavanje engleskog jezika je prednost.

Kandidati treba da predaju sledeća dokumenta:

- Prijavu zajedno sa CV-om
- Dokaze o školovanju, radnom iskustvu
- Kopiju lične karte ili pasoša

Data publikacije i zatvaranja konkursa: 28/01/2020 do 11/02/2020.

Podnošenje zahteva: Prijave se preuzimaju u Diviziji za ljudske resurse u Fondu za zdravstveno osiguranje i predaju se u kancelariji Divizije za ljudske resurse, kancelarija br. 13, na adresi: Prishtina, Kupusište, Ul. Tirana, objekat „Beni Dona“. U prijavi treba da se jasno navede naziv radnog mesta i broj reference. Dodatne informacije se mogu dobiti na ovaj br. telefona: 038 20080705

Prijave poslate nakon datuma zatvaranja konkursa i nepotpune prijave neće biti prihvaćene.

Petrit Bruqi
Rukovodilac divizije za ljudske resurse

